



FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE

PUNIMI I MAGJISTRATURËS

Krijimi i një kursi për mësim në distancë

KANDIDATI:

Kudret Rexhepi

MENTORI:

Doc.Dr. Azir ALIU

TETOVË, 2017

Deklaratë

Deklaroj se kjo tezë dhe puna e raportuar këtu, ka përbërje tërësisht origjinale. Informacioni i marrë nga puna e botuar ose e pabotuar e të tjerëve është cituar në tekst dhe referencat janë dhënë në listën e burimeve.

05.05.2017

Deklaratë

Me kërkesën e studentit Kudret Rexhepi;

Me kërkesën e studentit të UEJL, z.Kudret Rexhepi, deklaroj me përgjegjësi profesionale e morale se Punimi i Masterit “Krijimi i një kursi për mësim në distancë”, është shikuar kujdesshëm nga aspekti gjuhësor, respektivisht morfo-sintaksor, dhe si i tillë ai është korrekt në këtë drejtim, mbështetur në Standardin e shqipes letrare, dhe përfundimisht mund të merret si tekst, gjuhësisht i pranueshëm e i harmonizuar me rregullat drejtshkimore të shqipes.

Gjilan, Maj 2017

Me respekt;

Tahir Arifi; Magjistër i shkencave filologjike

Strukturimi i punimit

Lista e tabelave.....	6
Lista e figurave.....	7
1.Hyrje.....	8
Kapitulli I.....	9
2.0 Mësimi në distancë, një rrugë e re për të mësuar	9
2.1 Tiparet e mësimit në distancë.....	9
2.2 Qasje në përmbajtje zhvillimore të mësimit në distancë	10
2.3 Standardet e mësimit në distancë	10
Kapitulli II.....	12
3. Dizajnimi i Kursit për mësim në distancë	12
3.1 Analiza e nevojshme	13
3.2 Analiza e audiencës	13
3.3 Identifikimi me përmbajtjen e kursit.....	14
3.4 Përcaktimi i objektivave të të mësuarit	14
3.5 Strukturimi i kursit	15
3.6 Rast studimi	15
4. Përcaktimi i strategjisë mësimore të kursit.....	18
4.1 Metodologjia e materialit mësimor për kursin	18
4.2 Definimi i aspektit teknologjik.....	20
Kapitulli III.....	21
5. Zhvillimi i përmbajtjes së kursit.....	22
5.1 Kontributet në zhvillimin e kursit	22
5.2 Struktura e përmbajtjeve mësimore	22
5.3 Paraqitja e përmbajtjeve mësimore duke përdorur teknikat.	25
5.4 Paraqitja e shembujve.....	29
5.5 Integrimi i materialit multimedial	29
5.6 Zhvillimi praktik i kuizit dhe testeve.....	32
6. Zhvillimi i kursit	34
6.1 Regjistrimi në kurs.....	34
6.2 Organizimi i menysë	37
6.3 Publikimi i materialit mësimor	38
7. Implementimi i kursit për mësim në distancë.....	42

7.1 Nevoitet kryerja e vlerësimeve	43
7.2 Synimet dhe objektivat mësimore	44
7.3 Trajnimi i përdoruesve	44
7.4 Testimi i kursit	44
8.0 Shpërndarja e informacioneve	45
8.1 Krahësimi i platformave	47
8.2 Planifikimi i aktiviteteve dhe dokumentimi	52
8.3 Lehtësimi i aktiviteteve të nxënësve	54
8.4 Vlerësimi i kursit	55
8.5 Përdorimit i kursit në platformën EduonGo, Canvas dhe e-edukimi	55
Shtojca	63
Lënda e hulumtimit	63
Qëllimi i hulumtimit	63
Detyrat e hulumtimit	63
Teknikat e hulumtimit	64
Rezultati i hulumtimit	64
Pasqyra e të dhënave	64
Rezultatet e pyetësorit	64
Komentimi i pyetjeve	81
Konkluzat	85
Rekomandimet	86
Biblografia	87

Lista e tabelave

Tabela 1 – Niveli i njohurive të mësimdhënësve në përdorimin e teknologjisë	11
Tabela 2 – Sistemimi i temave mësimor.....	16
Tabela 3 - Planifikim i një ore mësimore	17
Tabela 4 - Organizimi i materialit mësimor me tekst, foto, video.....	19
Tabela 5 - Lehtësimi në përdorimin e kursit.....	20
Tabela 6 - Mundësitë e komunikimit në kurs	20
Tabela 7 - Efektiviteti i përmbajtjeve të materialit mësimor	22
Tabela 8 - Rezultatet mësimore.....	23
Tabela 9 - Video informuese në hyrje.....	24
Tabela 10 - Kombinimi i përmbajtjeve mësimore	24
Tabela 11 - Përmbledhje e objektivave	25
Tabela 12 - Demonstrimi i përdorimit të temave.....	26
Tabela 13 - Forma dhe teknika e prezantimit.....	27
Tabela 14 - Teknika qasje e bazuar në materiale	28
Tabela 15 - Shfrytëzimi i materialit shtesë	29
Tabela 16 - Përmbajtjet mësimore grafike	30
Tabela 17 - Përmbajtjet mësimore video	31
Tabela 18 - Përzgjedhja e pyetjeve të kursit.....	33
Tabela 19 - Krahasimi i platformave.....	50
Tabela 20 - Statistikat e krahasimit të platformave	51
Tabela 21 - Planifikimi i planprogramit mësimor	53
Tabela 22 - Organizimi i seancës parë	54
Tabela 23 - Përshtatshmëria e platformave	81
Tabela 24 - përgjigjet për materialin mësimor	83
Tabela 25 - Çfarë nuk ju ka pëlqyer në kurs	83
Tabela 26 - Vështirësitë e përdorimit të kursit.....	84

Lista e figurave

Figura 1 - Aktivitetet kryesore të kursit	15
Figura 2 - Përzgjedhja e materialit mësimor.	15
Figura 3 - Krijimi i përmbajtjeve mësimore.	18
Figura 4 – Struktura dhe organizimi i përmbajtjeve.....	23
Figura 5 - Regjistrimi i përdoruesve	34
Figura 6 - Vendosja e kodit përkatës	35
Figura 7 - Të dhënat kryesore për regjistrim	35
Figura 8 - Kyçja në kurs	36
Figura 9 - Menyja Kryesore(Tabela kërkuese).	37
Figura 10 - Krijimi i moduleve	38
Figura 11 - Shiriti punues	38
Figura 12 - Vendosja e materialit mësimor me tekst	39
Figura 13 - Vendosja e materialit mësimor me fotografi	40
Figura 14 - Vendosja e materialit mësimor me video	40
Figura 15 - Vendosja e videove në kurs	41
Figura 16 - Forma e implementimit	42
Figura 17 - Grafiku i statistikave	52
Figura 18 - Përzgjedhja e kursit	56
Figura 19 - Hyrje për regjistrim.....	56
Figura 20 - Regjistrohuni si nxënës i ri.....	57
Figura 21 - Krijoni përdoruesin	57
Figura 22 - Hyrja në kurs.....	58
Figura 23 - Desktopi i kursit.....	58
Figura 24 - Pamja fillestare e kursit	59
Figura 25 - Përmbajtja e temës mësimore me tekst dhe fotografi	60
Figura 26 - Përmbajtje vizuale	60
Figura 27 - Plotësimi i kuizit.....	61
Figura 28 - Vlerësimi i kuizeve	61
Figura 29 - E-edukimi video	62
Figura 30 - Canvas video	62
Figura 31 - Përshtatshmëria e platformave përmes grafikut	82

1.Hyrje

Teknologjia Informative është duke gjetur zbatim çdo ditë e më shumë në të gjitha fushat, dhe një ndër faktorët që ndikojnë më së shumti në përhapjen e kompjuterëve në botë është edhe shpejtësia e zhvillimit të teknologjisë Informative, sidomos me zhvillimin e pajisjeve kompjuterike, smartfonëve, tabletëve të ndryshëm, SmartBoard e aparateve digjitale, me ç'rast janë hapur rrugë të pafundme për zbatimin e tyre në praktikë, duke pasur mundësi që të arrijmë një qasje të lehtë dhe të drejtëpërdrejtë në arsimimin e gjeneratave të ndryshme, ku arsimimi dhe dituria janë baza e zhvillimit të çdo shoqërie.

Përdorimi i kompjuterëve në arsim, sjell arritjen e kompetencave-rezultateve të planifikuara në fusha të caktuara, duke pasur parasysh zhvillimin dhe avansimin e nxënësve për jetë dhe orientim në karrierë. Integrimi i teknologjisë informative dhe komunikimit për mesim në distancë nuk është vetëm një mundësi për të përparuar, por edhe një domosdoshmëri për ta bërë procesin e edukimit më atraktiv dhe tërheqës. Përdorimi i teknologjisë Informative dhe komunikimit duhet të fokusohet jo vetëm në mjetet e tij, por gjithashtu është shumë i rëndësishëm të përfshihet në një pedagogji të drejtë në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, ashtu siç është mësimi në distancë.

Si lëndë hulumtimi në këtë tezë magjistrature kam marë krijimin e një kursi për mesim në distancë, që mundëson një qasje më të mirë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Në këtë tezë do të jap disa të dhëna që kanë të bëjnë me dallimin e mësimdhënies në distancë dhe mësimdhënies të ndryshme me metoda dhe teknika të ndryshme, të cilat nuk mund t'i përgjigjen zhvillimeve të reja duke marrë parasysh efektin i cili rrit kreativitetin në mësimdhënie dhe mësimnxënie, mundëson që nxënësit të jenë më të suksesshëm.

Për të arritur një zhvillim më të mirë duhet të bëjmë avansimin e metodave të reja interaktive siç është mësimi në distancë. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit në edukim duhet nënkuptuar si një implementim i pajisjeve dhe mjeteve teknologjike në procesin mësimor për të regjistruar dhe përpunuar informacionin në formë digjitale.

Mësimi në distancë bazohet në sistemin për përcjellje dhe menaxhim të procesit mësimor i njohur si sistem LSM, i cili përfshinë një grup të veprimeve siç janë përcjellja e përparimit të nxënësve, bashkëpunimi midis nxënësve dhe mentorit. Institucionet edukative-arsimore duke parë përparimin e madhe të teknologjisë informative dhe komunikimit në botë shqyrtojnë mundësi për të zhvilluar sisteme për edukimin në distancë përbrenda institucioneve të ndryshme.

Integrimi i mësimin në distancë mund të jetë si metodologji, për të arritur objektivat e lëndëve të caktuara në fusha të caktuara; përdorimi i mësimin në distancë nga mësimdhënësit do të ndihmojë mirë në menaxhimin e të dhënave dhe arritjen e rezultateve për lëndët. Mësimi në distancë, rrit autonominë në mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe ka për qëllim nxitjen dhe zhvillimin profesional të të gjitha kategorive edukative-arsimore, me synim rritjen e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të tyre, në funksion të përmbushjes së nevojave për të mësuar gjatë gjithë jetës.

2.0 Mësimi në distancë, një rrugë e re për të mësuar

Zhvillimi madh i internetit u mundëson njerëzve qasje të pafund në informacione dhe njohuri, në mënyrë efikase dhe të përshtatshme në kohë. Me përparimin e teknologjisë kompjuterike dhe asaj mobile bëhet e mundur qasja në informacion dhe të mesuarit online 24 orë në ditë. Në kohën e sotshme dihet botërisht, se shumë nga institucionet edukativo-arsimore përdorin mësimin në distancë për të ofruar përmbajtje arsimore që t'u bëhet më e lehtë qasja në përmbajtje përmes kurseve të ndryshme. Përdorimi i kurseve online mundëson arritjen e rezultateve të parapara për kursin përkatës si dhe rritë produktivitetin profesional.

Mësimi në distancë është i njohur si qasje në internet duke përfshirë pajisjet elektronike që kanë koneksionin me internetin për të mundësuar arsimimin në fusha të ndryshme. Komponentët e mësimin në distancë mund të ofrojnë përmbajtje arsimore në forma të ndryshme të ndërtimit të materialit dhe menagjimit si dhe përvojës së të nxënësit. Mësimi në distancë përfshinë sisteme të ndryshme të të mësuarit, si klasë virtuale të mbyllura apo klasë publike me qasje falas me qëllimin më të mirë për të arritur rezultatet në fusha të ndryshme përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, me qasje online¹.

2.1 Tiparet e mësimin në distancë

Në institucionet edukativo-arsimore mbizotëron forma e edukimit tradicional të mësimdhënies dhe mësimnxënies, ku mësimi në distancë ka potencial të revolucionarizoj përparësitë e një mësimi më të shpejtë e me kosto të reduktuar, duke bërë pjesëmarrësit e tij përgjegjës dhe llogaridhënës. Mësimi në distancë u mundëson shkollave të bëjnë përpunimin e informacioneve për lëndët mësimore. Mësimdhënësit dhe nxënësit mund të kenë qasje në lëndët e tyre edhe jashtë orarit të mësimin të rregullt, atëherë kur është më e përshtatshme për ta, nga zyra apo shtëpia. Disa karakteristika të mësimin në distancë mund të identifikohen si në vijim:

Personalizimi. Avansimi dhe edukimi i nxënësve dhe studentëve në vazhdim do të jetë i orientuar në formë të personalizuar. Kurset e ndërtuara për mësim në distancë do të jenë të përzgjedhura në bazë të interesit të nxënësve, nivelit arsimor si dhe mjedisit, nevojës shoqërore me përcaktim të rregulluar me ligj nga institucioni përgjegjës arsimor.

Ndërveprimi dhe Ripërdorimi. Përzgjedhja e sistemit për kurset mësimore bëhet nga institucioni përkatës me qëllim të aftësimin dhe menagjimit më të lehtë të sistemit përkatës. Përmbajtjet mësimore mund të ripërdoren në aplikime të ndryshme, panvarësisht formës së ndërtimit të tyre. Ripërdorimi i materialit, me të drejtë, mund të përsëritet gjatë përfundimit të semestrit ose në përfundim të viti shkollor.

¹ E-LEARNING CONCEPTS, TRENDS, APPLICATIONS faqe 5.

Fleksibiliteti. Nxënësi mund të përdorë lloje të ndryshme të paisjeve teknologjike për të pasur qasjen në përmbajtjet mësimore. Forma dhe organizimi i kursit duhet të jetë i barabartë për të gjithë nxënësit pjesëmarrës të regjistruar si ndjekës të kursit.

2.2 Qasje në përmbajtje zhvillimore të mësimin në distancë

Organizimi i infrastrukturës së mësimin në distancë në mjediset arsimore nuk është edhe aq i lehtë, në kuptimin e të krijuarit të materialeve mësimore e përpunimi të tyre, ku duhet pasur parasysh faktorin kohë. Në shumicën nga institucionet arsimore për të ulur koston e shpenzimeve nga kontraktuesit e dyfishtë, u jepet mundësi mësimdhënësve lëndor që të krijojnë përmbajtje mësimore, duke u bazuar në planprogramet mësimore me përmbajtje elektronike. Kjo formë e organizimit të kurseve shënon ulje të koston e shpenzimeve dhe jep mundësi ripërdorimi të përmbajtjeve mësimore nga nxënësit dhe mësimdhënësit.

Në rast ndryshimi të platformës, materiali i përpunuar nga mësimdhënësit lëndor mund të bartet e ripërdoret në platformën e re, duke pasur parasysh interesin e nxënësve, institucionit dhe avansimi i versioneve teknologjike.

2.3 Standartet e mësimin në distancë

Sot kemi një zhvillim të shpejtë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, ku bota karakterizohet nga këto ndryshime të shumta dhe të shpejta. Arsimi duhet t'i përcjellë dhe t'u përshtatet ndryshimeve të mëdha të teknologjisë, si dhe t'i bëjë funksionalë duke i përdorur ato gjerësisht në procesin mësimor.

Me zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përdorimi i teknologjisë gjatë procesit mësimor është bërë i domosdoshëm për të mësuar dhe avancuar; në vendet më të zhvilluara mund të shohim se si ka filluar të përditësohet përdorimi i teknologjisë informative².

Për të pasur një sukses më të madh në arritjen e rezultateve në fusha të ndryshme, nxënësit dhe mësimdhënësit duhet të shfrytëzojnë në mënyrë efektive teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, ku mund t'i përmendim disa elementë bazë ndihmës për nxënësit:

- Komunikues efektiv, bashkëpunues,
- Kërkues, analizues dhe vlerësues i informacionit,
- Përdorues i informacionit e teknologjisë,
- Kontribues produktiv,
- Qytetar i përgjegjshëm, i informuar,
- Zgjidhjen e problemeve dhe marrës i vendimeve.

² Strategjia Nacionale për Zhvillimin e Shoqërisë Informatike 2005-2015

Standardi – Zhvillimi profesional i mësimeve

Zbatimi i kësaj qasjeje bazohet në zhvillimin e njohurive elektronike dhe përdorimin e teknologjisë informative dhe komunikimit për ngritjen dhe avansimin profesional të mësimeve³. Mësimeve duhet të kenë njohuri në përdorimin e teknologjisë, burimeve të nevojshme nga interneti dhe materiale të ndryshme për të pasur në vazhdim një mësime të mirë dhe zhvillim profesional të tyre⁴.

NIVELI FILLESTAR		NIVELI MESATAR		NIVELI AVANSUAR	
Rezultatet	Pjesa praktike	Rezultatet	Pjesa praktike	Rezultatet	Pjesa praktike
Mësimeve të jenë të aftë : Të përdorin burimet e teknologjisë informative për të rritur produktivitetin si mësimeve. Të përdorin burimet e TIK-ut si mbështetje në përvetësimin e njohurive të lëndëve të tyre.	Mësimeve aplikon burimet e komunikimit për t'u avansuar profesionalisht Mësimeve të përdorin TIK-un për të zgjeruar informacionet për lëndën mësimore. Mësimeve të bashkëpunojnë me vete duke hartuar planin për përdorim të teknologjisë informative.	Mësimeve të jenë të aftë : Të përcaktojnë burime të ndryshme nga internet dhe burime të tjera për të mbështetur zhvillimin e tyre profesional Të identifikojnë burime të ndryshme për menagjimin e informacioneve për të mbështetur zhvillimin e tyre profesional.	Mësimeve të përdorin teknologjinë informative si burim kryesor që mbështet zhvillimin e tyre profesional. Mësimeve të bëjnë kërkime të vazhdueshme në internet duke komunikuar me specialistë dhe profesionistë për të nxitur pjesëmarrjen aktive në aktivet profesionale.	Mësimeve të jenë të aftë : Krijojnë një projekt për shkollën e tyre me përdorimin e teknologjisë informative dhe komunikimit. Të kenë bashkëpunim dhe fleksibilitet të nivelit të lartë me aktivet tjera profesionale brenda shkollës dhe komunitetit.	Bashkëpunimi i mësimeve duhet të jetë në nivel aktiv, shkolle, rajoni dhe më gjerë Në rast të vështirësive mësimeve bashkëpunojnë shumë mes vete për t'i tejkaluar ato sfida. Mësimeve integrojnë burimet e teknologjisë informative që mund t'i përdorin për përmirësim të vazhdueshëm të platformës.

Tabela 1 – Niveli i njohurive të mësimeve në përdorimin e teknologjisë

³ Mar nga Insituti i Zhvillimit të Arsimit ,Ministria e Arsimit dhe Shkencës

⁴ Joy Egbert and Elizabeth Hanson-Smith., CALL Environments: Research, Practice, and Critical Issues

Kapitulli II

3. Dizajnimi i kursit për mësim në distancë

Faza e analizës dhe dizajnit janë pika thelbësore për të siguruar efektivitetin e kursit, motivimin e nxënësve dhe pjesëmarrje të vazhdueshme, duke pasur parasysh nevojat e nxënësve, qasjen në përmbajtjen mësimore dhe aktivitetet mësimore, përdorimi teknologjisë është vendimtar në ngritjen e cilësisë dhe efektin e kursit⁵.

- Për të krijuar një kurs efektiv varet nga disa elemente të ndryshme siç janë:
- Lidhja e përmbajtjeve dhe objektivat e kursit për pjesëmarrësit: a i përmbushin kërkesat ekzistuese?
- Aktivitetet mësimore të ofruara nga kursi: A janë interesante, a përputhen me nivelin e nxënësve?
- Kohëzgjatja e kursit, orët e parapara: A përshtaten me disponueshmërinë e nxënësve?
- Aspektet teknike: A është zgjedhje e kursit të duhur për nxënësit? A është i qartë dhe funksional përdorimi i platformës së të mësuarit për pjesëmarrësit?

Gjatë krijimit të një kursi duhet pasur parasysh disa koncepte dhe ide themelore që duhet të jenë më të qarta për përdoruesin. Për dizajnuesin e kursit kuptohet se ideja e objekteve mësimore kërkon një ndryshim të madh në të menduarit kritik⁶. Duke pasur parasysh formën e të mësuarit me metodologjitë tradicionale, ne tani duhet të ndryshojmë të mësuarit si grupe të pavarura, qëllimet dhe rezultatet e të nxënësve. Pra, dizajnuesi duhet të jetë i kujdesshëm gjatë përcaktimit të objektivave dhe rezultateve të të nxënësve duke bërë sistemimin e duhur të të dhënave, për të pasur një kurs të përshtatur dhe të suksesshëm për përdoruesit në forma individuale.

Gjatë krijimit të objekteve ne duhet të kemi kujdesi sistemimin e tyre, duke pasur parasysh qasjen më të lehtë në objekte dhe për të pasur një kurs të mirë, duhet të sigurohemi që gjatë ndërtimit të objekteve mësimore, duhet paraqitur objektiva të qarta, përmbajtje të integruar e aktivitete të ndryshme, me qëllimin kryesor arritjen e rezultateve që dalin nga kursi⁷. Është e nevojshme të përshkruhet organizimi, strukturimi i objekteve mësimore të përcaktuara nga përfundimi i programit të kursit. Qëllimi kryesor është që të bëjmë dizajnin e kursit të përshtatshëm për përdoruesit në mënyrë individuale. Objektivat e mësimit janë deklarata të vendosura në fillim të çdo kursi për ta pasur si informacion për shfrytëzuesit, mbi përmbajtjen e kursit.

⁵ 15 Learning objectives can also include performance conditions (i.e. the context in which the behaviour will be performed, such as “orally”); and performance criteria

⁶ 18 A learning object is the smallest reusable collection of content supporting a specific learning concept or objective.

⁷ 19 A modular curriculum is made up of standardized units that can be separated from each other and rearranged or reused.

3.1 Analiza e nevojshme

Analiza është e nevojshme për qështjet organizative të kursit, që funksionalizimi i tij të jëtë në nivelin e duhur të punës. Para krijimit të një kursi për mësim në distancë, gjatë analizës ne përcaktojmë nëse:

- Nëse është e nevojshme të plotësohen disa hapësira profesionale,
- Kursi në distancë është një zgjedhje e mirë për të ofruar avansim.

Në institucionet ku aplikohet mesimi në distancë mund të ketë edhe probleme të natyrave të ndryshme, duke përfshirë:

- Mjedisin punues – kushtet,
- Qështjet oraganizative,
- Kapacitetet në aktive profesionale.

Funksionalizimi dhe përmirësimi i problemeve kërkon kohë dhe aktivitet për t'u përmirësuar. Nëse një mësimdhënës nuk është në gjendje të përdorë teknologjinë informative, konkretisht aplikimn e kursit, atëherë si zgjidhje e mundur mund të jetë bashkëpunimi me mësimdhënësit e tjerë dhe trajnimi i vazhdueshëm për platformën e kursit.

Mësimdhënësit gjatë mësimdhënies shpeshherë kanë probleme të natyrave të ndryshme me mjetet teknologjike që kanë në përdorim, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë direkte në performancën e tyre ,duke pasur parasysh amortizimin e mjeteve e kabineteve, e që si problem i tillë duhet të trajtohet në instanca më të larta.

3.2 Analiza e audiencës

Sot, mësimi në distance, kryesisht aplikimi i kurseve, është një zgjidhje e mirë për të mësuar dhe avansuar në shoqëri. Audienca mund të identifikojë shumë faktorë të ndryshëm që ndikojnë në dizajnimin e një kursi, ku mund t'i përmendim disa prej faktorëve:

- Institucioni ku nxënësit mësojnë dhe avansimi i tyre profesional i ndihmon nxënësit të arrinë rezultatet dhe qëllimet mësimore për çdo grup të audiencës duke pasur parasysh përshtatjen e modelit të kursit.
- Përvoja e nxënësve në platforma të tjera u mundëson që të kenë përparësi në përdorimin e kursit pa pasur ndonjë trajnim shtesë.
- Koha e disponueshme për mësimin në distancë – Aplikimi I temave me përmbajtje audio-vizuele ndihmon në avansimin e kohës.

- Vendet ku nxënësit ndjekin kursin mund të jenë të ndryshme; në shkollë, shtëpi e punë me qasje në internet– Këtu mund të ketë disa kufizime të rrjetit që nxënësit mund të bëjnë download apo upload nga kursi që ndjekin.

3.3 Identifikimi me përmbajtjen e kursit

Gjatë hartimit të kursit është e nevojshme të identifikohen qëllimet dhe rezultatet kryesore të lëndës përkatëse. Identifikimi i përmbajtjes mësimore është hapi më i rëndësishëm i projektimit të kursit, ku gjatë dizajnit, nëse nuk e përfshihet përmbajtja e mirë, atëherë kursi jonë nuk do të jetë në nivelin e duhur për të zhvilluar një mësim cilësor e që rezultatet do të jenë pak të arritura.

Hartimi i planëprogrameve mësimore është një parakusht për zhvillimin e kursit dhe arritjen e rezultateve të parapara në programin mësimor. Analiza dhe identifikimi i përmbajtjes mund të jetë funksional nëse i zbatohet teknikat e cekura më poshtë:

- **Identifikimi i detyrave** që dalin nga planprogrami mësimor, që nxënësit duhet të ushtrojnë, mësojnë për t'i zhvilluar dhe avansuar aftësitë e tyre.
- **Identifikimi i temave mësimore** dhe sistemimi i tyre sipas planprogramit të hartuar për kursin.

3.4 Përcaktimi i objektivave të të mësuarit

Gjatë identifikimit të detyrave dhe temave mësimore është më e lehtë për të përcaktuar objektivat e të mësuarit përgjatë zhvillimit të kursit.

Rezultatet e të nxënës të lëndës, përkatësisht objektivat dhe qëllimet e lëndës përcaktohen nga dizajneri i kursit, konkretisht mësimdhënësi i lëndës, i cili hartimin e rezultateve e përgadit me qëllimin që nxënësit t'i arrijnë ato rezultate në mënyrën më të mirë të mundshme

Rezultatet ose objektivat e lëndës krijohen nga temat mësimore; rezultatet e lëndës i bënë mësimdhënësi i lëndës përkatëse me një bashkëpunim të ngushtë me aktivin profesional, duke u bazuar në Kornizën kurrikulare të arsimit përkatës e me synimin që këto rezultate t'i bëjnë nxënësit, kompetentë në fushat përkatëse.

Me arritjen e objektivave dhe rezultateve të lëndës ne i kemi avansuar nxënësit si:

- Komunikues efektiv,
- Nxënës i sukseshëm,
- Qytetarë i përgjegjshëm.

Objektivat e të mësuarit mund t'i ndërlidhim me dy elemente kryesore:

- Materiali mësimor (përcaktimi i rezultateve që synohen të arrihen si objektiva)
- Arritja e rezultateve (të përcaktuara nga temat dhe njësitet mësimore)

3.5 Strukturimi I kursit

Strukturimi i kursit është i nevojshëm të paraqitet në formë grafike, me faktin që ai do të jetë efektiv dhe kontribues në arritjen e qëllimit të kursit. Struktura e kursit përfshinë disa sesione të ndara si objekte në vete, të cilat përmbajnë: tekst, foto, video dhe elemente të tjera.





Figura 1 - Aktivitetet kryesore të kursit

3.6 Rast studimi

Hartimi i planporgrameve, kuptohet që merr shumë kohë, veçanërisht kur bëhet fjalë për material mësimor dhe perpunim të tyre në tekst, foto a video. Studimi në vazhdim tregon se si është bërë përgaditja dhe përzgjedhja e materialit për të zhvilluar kursin e teknologjisë informative- Excel 2013 për nxënësit e klasës së X-të.

Krijimi i kursit për mësim në distance “ Teknologjia Informative dhe Komunikimi për klasët e X-ta” në Gjimnazin “Zenel Hajdini” është bërë i mundur me një grup nxënësish të klasëve të 12-ta dhe Aktivit profesional të mësimdhënësve të TIK-ut.



Materiali mësimor është përzgjedhur nga Aktivi profesional I TIK-ut dhe nxënësit e shkollës. Në këtë kurs nxënësit do të mësojnë Excel 2013 –aplikacion, i cili është në interes të nxënësve si përparësi dhe nevojë për avansimin e tyre në shoqëri.

Figura 2 - Përzgjedhja e materialit mësimor⁸.

⁸ Figura 2. Marrë nga internet

Hartimi i planit të kursit

Gjatë takimeve me grupet punese dhe mësimdhënësit e TIK-ut është bërë plani për kursin që do të ndjekin nxënësit e klasëve të X-ta. Nga punëtoritë është nxjerrë rezultati i temave mësimor që do të zhvillohen në kursin Excel 2013; në vazhdim ju paraqesim strukturën e kursit:

Kursi: Teknologjia Informative dhe Komunikimit Excel 2013	
Temat Mësimore	Përshkrimi
* Cfarë është Excel 2013 dhe për çfarë përdoret?	Exceli është një program për kalkulimin e tabelave, i cili është zhvilluar nga kompania Microsoft dhe bënë pjesë në paketin e Microsoft Office
* Dritarja e Excel-it dhe përdorimi i menysë	Me hapjen e programit Excel 2013 në ekran paraqitet dritarja kryesore e exeli-it
* Libri punues dhe fletët punuese	Menaxhimi i librave punuese bëhet në regjistrin File , që ndryshe njihet edhe si pamje e prapaskenës (Backstage View).
* Puna me Qeliza	Sipërfaqja punuese e Excel-it, është një tabelë e madhe, pothuajse “e pakufizuar”.
* Formatimi i qelizave	Formatimi i qelizave është një hap shumë i rëndësishëm në krijimin e tabelave me pamje profesionale
* Puna me rreshta dhe shtylla	Në Excel, fletët punuese kanë fiks të reshtave dhe shtyllave, i cili numër nuk mund të ndryshohet.
* Formulat dhe Funkcionet	Excel-i është një program aplikativ shumë i fuqishëm, që përdoret për llogaritjen dhe kalkulimin e tabelave
* Diagramet paraqitja grafike e të dhënave	Përveç kalkulimit të tabelave të të dhënave, Excel-i është një program i njohur edhe për prezantimin e të dhënave me anë të diagrameve
* Fshehja e të dhënave	Fshehja e të dhënave në Excel 2013 në disa raste është e nevojshme që të bëjmë fshehjen e tyre
* Zhvendosja dhe kopjimi	Zhvendosja me metodën Drag & Drop (tërhiq dhe lësho).
* Sortimi dhe filtrimi i të dhënave	Sortimi nënkupton renditjen e të dhënave të paraqitura në tabelën sipas cilësdo fushë të saj
* Shtypja	Fleta punuese e krijuar mund të shtypet në letër në çdo moment.
* Siguria e fletës punuese	Siguria e fletës punuese bëhet në rastet kur kompjuterin ose konkretisht aplikacionin e excelit e përdorin fillestarët për të mësuar kursin.

Tabela 2 – Sistemimi i temave mësimore

Më poshtë është paraqitur një model, plan i një ore mësimore me rezultatet e parapara dhe të pritura nga tema mësimore.

ASPEKTET E PERGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Fusha kurrikulare: <u>Jeta dhe puna</u> / lënda: <u>TIK</u> / Shkalla e kurrikulës: <u>V</u> / Klasa: <u>X</u> / Ora: <u>1 Tipi orës: Zhvillim</u>
Koncepti bazë i fushës kurrikulare: Teknologji duke përfshirë TIK-un Tema / Njësia mësimore: Programet Aplikative/ Hyrje Excel 2013
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën e V: 1. Komunikues efektiv 1.2; 1.9 2. Mendimtar kreativ 2.2. Nxënës i suksesshëm 3.2; 3.3;
Kontributi në rezultatet e fushës kurrikulare për shkallën e V: <u>1, 1.1; 2, 2.1; 3, 3.1;</u>
ASPEKTET SPECIFIKE TE PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Fjalët Kyqe: Excel, startimi, fajli, mbyllja, aplikacion, elementet
Rezultatet e te nxënës: Nxënësi e hapë dhe e mbyllë (A) aplikacioni Excel 2013 (O) në mënyrë të rregullt & në forma të ndryshme (K)
Kriteret e suksesit: Demonstron hapat për mbyllje dhe hapje të programin në disa mënyra.
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabela (e bardhë) me marker, libri , Kompjuteri, Projektori, Interneti
Përdorimi i TIK-ut: Projektori, Kompjuteri, Interneti
Korelacioni me fushat kurrikulare dhe çështje kurrikulare: 1. Gjuhë dhe komunikim – Gjuhë angleze (leximi dhe shqiptimi i drejte i fjalëve), 2. Matematikë
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Evokim: (Stuhi mendimesh), (Diskutim)- (5 –7 minuta) Mësimdhënësi përmes kompjuterit me projektor prezanton njësine mësimore (titujt) para nxënësve. Mësimdhënësi bënë disa pyetje për diskutim; Ç'është programi Excel 2013? Çka mundëson ai? Nxënësit japin idetë dhe mendimet e tyre lidhur me njësine mësimore duke u bazuar në njohuritë paraprake.
Realizim: Demonstrim (23 minuta) Nxënësit Logohen në kursin Excel 2013. Fillimisht lexojnë njësine mësimore në tekst dhe foto, më pas mësimdhënësi i ftonë ata të përcjellin temën në video. Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të komentojnë para të tjerëve video materialin e parë.
Reflektim: (10 – min) Demonstrim- Nxënësit me kompjuter demonstrojnë informacionet e marra nga tema e re hyrje në Excel 2013. Mësimdhënësi Kudret Rexhepi

Tabela 3 - Planifikim i një ore mësimore

4. Përcaktimi i strategjisë mësimore të kursit

Në këtë pjesë të kapitullit do të jepen disa informacione rreth krijimit të përgjithshëm të kursit



Para se të fillojmë me fazën e zhvillimit të kursit është e nevojshme të mendohet se qfarë përmbajtje mësimore do të krijojmë⁹. Përmbajtja mësimore do të krijohen me përmbajtje interactive më mundësi të vetë mësimi nga nxënësit, text, foto, video, animacione etj.

Figura 3 - Krijimi i përmbajtjeve mësimore¹⁰.

4.1 Metodologjia e materialit mësimor për kursin

Dizajnimin i kursit do të përfshijë disa nga metodologjitë mësimore të përmendura më poshtë¹¹:

- Metodologjia përshkruese – përfshinë materialet mësimore me tekst, foto, video dhe prezantime tjera.
- Metodologjia e aplikimit – nxënësit përdorin aplikacionin duke e përshtirë demonstrimin dhe praktikën p.sh aktivitetet e ndryshme, kuizet, detyrat e testet.
- Metodologjia e bashkëpunimit – Nxënësit bashkëpunojnë mes vete dhe i shkëmbejnë përvojat e fituara gjatë ndjekjes së kursit.

Metodologjia përshkruese

Mësimdhënësi jep informacionet për temën e caktuar, në këtë rast nxënësit dëgjojnë dhe lexojnë materialin mësimor, ndërsa mësimdhënësi me këtë metodë merr informatat nga nxënësit, ta zëmë, se sa janë të njohur ata me temën që do të zhvillohet në vazhdim.

⁹ E-learning methodologies A guide for designing and developing e-learning courses

¹⁰ E-learning methodologies A guide for designing and developing e-learning courses page 44

¹¹ Bashkim Azemi & Bekim Morina; Aparatura didaktike në tekstet shkollore, Prishtinë, 2013, Instituti Pedagogjik i Kosovës

Nxënësit mund të përdorin edhe materialin mësimor për temën përkatëse, edhe përmes fotove dhe videos. Gjatë ndjekjes së kursit mund të praktikojmë shumë metoda të sistemit të materialit mësimor, të cilat i kemi treguar më poshtë:


Metodologjia përshkruese	
	Përmbajtja e mëterialit mësimor si dokumet dhe prezantime me PoëerPoint
	Përmbajtje interaktive duke përdorur tekst, foto, audio, animacione
	Përmes Videos së përgaditur nga mësimdhënësi nxënësve u ofrohet tema mësimore, të cilën mund ta shikojnë në çfarëdo kohe.

Tabela 4 - Organizimi i materialit mesimor me tekst, foto e video

Metodologjia e aplikimit

Nxënësit me metodologjinë e aplikimit bëjnë praktikimin e kursit, duke filluar nga aktivitetet, siç janë ushtrimi i detyrave e kuizet, ku shumicën e informatave i marrin nga mësimdhënësi, për atë se si mund ta përdorin kursin në mënyrë efektive.

Metodologjia e bashkëpunimit

Kjo metodologji i avanson nxënësit si mund të përdorin kursin pa pasur ndonjë problem që mund ta pengojë gjatë ndjekjes së kursit, edhe atëherë kur ata nuk janë në klasë. Të gjitha instruksionet fillestare i marrin nga mësimdhënësi, ku gjatë ndjekjes së kursit shkëmbejnë informacionet mes vete dhe me mësimdhënësit, për të qenë sa më të familjarizuar me kursin.

Metodologjinë e bashkëpunimit mund ta praktikojmë në dy forma:

Metodologjia e bashkëpunimit	
	Duke përdorur një material multimedial me të cilin bëhet demonstrimi i përdorimit të kursit.
	Pas regjistrimit të nxënësve në kurs mësimdhënësi u lejon të bashkëpunojnë e diskutojnë bashkarisht për përdorimin sa më të mirë të kursit.

Tabela 5 - Lehtësimi në përdorimin e kursit

Në rast të publikimit të detyrave për temat e caktuara të kursit, nxënësit obligohen t'i kryejnë detyrat në bazë të kërkesës që ka parashtruar mësimdhënësi, ku bashkëpunimi mes nxënësve sjell rezultatin e dëshiruar.

Metodologjia e bashkëpunimit	
	Nxënësit e kanë forumin për diskutim të detyrave përmes bisedave, emaileve, publikimeve e materialeve të tjera dokumentare.

Tabela 6 - Mundësitë e komunikimit në kurs

4.2 Definimi i aspektit teknologjik

Sa i përket aspektit teknologjikë duhet të kemi parasysh disa faktorë:

- Bashkëpunimi i nxënësve me materialin mesimor,
- Aspekti i teknologjisë,
- Çështjet organizative.

Bashkëpunimi i nxënësve me materialin mesimor

Gjatë ndjekjes së kursit është shumë e nevojshme dhe e rëndësishme se çfarë komoditeti e përshtatje kanë nxënësit me materialin mësimor (tekst, video, detyrat, kuizet), duke pasur parasysh që nxënësve ju nevojitet kohë për të lexuar e diskutuar ne zgjidhjen e detyratve apo kuizeve.

Në rast së nxënësit nuk kanë përcjellur materialin mësimor përmes tekstit apo videos dhe kanë realizuar vetëm komunikimin përmes emailit, kuptohet që kanë vështirësi në avansimin e tyre me materialin mësimor.

Shfrytëzimi i kohës; nëse nxënësit janë të vendosur në zona të ndryshme kohore dhe koha më e përshtatshme për nxënësit.

Aspekti i teknologjisë

Infrastruktura e kabineteve teknologjike, gjendja funksionale e tyre të furnizuar me internet për të pasur qasje më të lehtë dhe të shpejtë, aftësitë e nxënësve për të përdorur teknologjinë informative, konkretisht aplikimin e kursit¹².

Shumica prej aktiviteteve kryhen me kyqjen në internet. Rëndësi të veçantë ka shpejtësia e kompjuterëve dhe internetit.

Çështjet organizative

Çështje organizative janë të shumta, por si më e rëndësishmja është koha në dispozicion, e cila do të ndikojë në zhvillimin e të mësuarit, kryesisht në përgaditjen e materialit nga mësime dhënësi dhe shfrytëzimin nga nxënësit.

Për ndërtimin e kursit, e kemi theksuar edhe më herët, ka shumë rëndësi koha, mirëpo nëse njëherë kemi ndërtuar një material të mirë nuk do të thotë se kemi gabuar vetëm se në vazhdim do të bëjmë ndryshime të tjera, pra do të bëjmë përshtatjen e versioneve dhe platformës së re.

¹² E-learning methodologies A guide for designing and developing e-learning courses page 46,47

Kapitulli III

5. Zhvillimi i përmbajtjeve të kursit

Përmbajtjet mësimore duhet të jenë të organizuara dhe strukturuara mirë në mënyrë që nxënësit gjatë shfrytëzimit të kursit të jenë sa më efektiv. Përmbajtjet mësimore mund të jenë të përpunuara nga mënyra më e thjeshtë, si tekst, e deri tek ato me përmbajtje interaktive. Metodologjitë dhe teknikat e përdorura në kurs mundësojnë lehtësi për arritjen e rezultateve të lëndës, nga nxënësit dhe mësime mësimore. Përgjatë këtij kapitulli do të tregojmë se si mund t'i përgadisim përmbajtjet mësimore për kursin.

5.1 Kontributet në zhvillimin e kursit

Në kapitullin e mëparshëm e kemi përmendur faktin se kush kontribuon në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore, mirëpo faktori kryesor është mësime mësimore. Nxënësit gjatë ndjekjes së kursit kanë nevojë për shumë materiale mësimore të zhvilluara nga mësime mësimore, në forma të ndryshme, si tekst, video, animacione etj. Nëse në kurs nuk është kontribuar mirë me përmbajtjen e duhur të materialit mësimor, nuk do të ketë rezultate të mira nga nxënësit.

Përbërja e materialit:

- Udhëzuesi teknik për përdoruesit,
- Organizimi i përmbajtjeve mësimore,
- Përbërja e materialit mësimor: tekst, foto, audio, video, animacione e material të tjera.



Më përmbajtje mësimore, konkretisht, gjatë zhvillimit të një teme mësimore, dikush nga audienca mund të bëjë pyetje; ta zëmë, sa kohë mund të merr një përmbajtje mësimore gjatë ndjekjes së saj? Atëherë për të arritur objektivat, rezultatet e njësive mësimore nuk duhet të marrin më shumë se dyzet minuta kohë. Do të thotë, për çdo temë mësimore duhet të kemi planifikimin e duhur, për të qenë sa më shumë efektiv.

Tabela 7 - Efektiviteti i përmbajtjeve të materialit mësimor

5.2 Struktura e përmbajtjeve mësimore

Në mësimdhënie dhe mësimnxënie është shumë e rëndësishme struktura dhe organizimi i përmbajtjeve mësimore. Në vijim është paraqitur një strukturë më përmbajtje mësimore¹³.




Figura 4 – Struktura dhe organizimi i përmbajtjeve

Në tabelën e mëposhtme mund të shohim elementet mësimore më të detajuara.

Elementet mësimore	Shembulli
1)Çdo temë apo njësi mësimore duhet të përmbajë rezultatet e të nxënit që synojmë t'i arrijmë përgjatë aplikimit të materialit	Fillimi dhe përfundimi i programit të Excel 2013 Ekzistojnë mënyra të ndryshme për startimit e excel 2013: 1) Shtypim butonin Sart  dhe klikoni në All Programs Microsfot Office Microsoft Excel 2013 në sistemin operativ Windovës 7, mirëpo është treguar edhe mundësia e hapjes së Excel 2013 edhe në sismemin operativ Windows 8, i paraqitur në figurën e mëposhtme. Përfundimi i punës në programin Excel 2013. Për të përfunduar punën në Excel 2013 ekzistojnë disa mënyra: 1) Nëse klikojmë në butonin X për mbyllje tek pullat active  2) Nëse klikojmë në mënyrë File dhe pastaj e zgjedhim komandën  Rezultatet mësimore Në përfundim të kësaj njësie, nxënësi do të jetë në gjendje: të hapë dhe e mbyllë (A)aplikacioni Excel 2013 (O)në mënyrë të rregullt, në forma të ndryshme(K)

Tabela 8 - Rezultatet mësimore

¹³ 21 The standard structure of an e-learning lesson reflects Gagné's nine events of instruction: 1) Gain attention; 2) Inform learner of objective; 3) Stimulate recall of prior knowledge; 4) Present the material; 5) Provide guidance for learning; 6) Elicit performance; 7) Provide feedback; 8) Assess performance; and 9) Enhance retention and transfer (See Gagné 1985)


Elementet mësimore	Shembulli
2)Hyrje – Në hyrje përmes një video përshkruhet informatata e përgjithshme për materialin mësimor. Qëllimi i hyrjes është për të motivuar nxënësit që ta ndjekin këtë kurs	EXCEL 2013  Hyrje Videoja e paraqitur në hyrje, rrit motivin e nxënësve për ta ndjekur kursin e Excel 2013.

Tabela 9 - Video informuese në hyrje


Elementet mësimore	Shembulli
3)Përmbajtja – për të lehtësuar materialin mësimor përdorim kombinimin e përmbajtjes si p.sh: text, foto, audio, video dhe kuizet përbrenda çdo përmbajtjeje mësimore.	 Libri punues dhe fletët punuese Menaxhimi i librave punues bëhet në regjistrin File, që ndryshe njihet edhe si pamje e prapaskenës (Backstage View). Kjo pamje i përmban komandat për krijimin e librit të ri punues, pastaj hapja e librit punues ekzistues si dhe ruajtja e shtypja e librit punues.

Tabela 10 - Kombinimi i përmbajtjeve mësimore

Elementet mësimore	Shembulli
4)Përmbledhjet – qëllimi kryesor është për t'i motivuar nxënësit për të mësuar, si vlerësim për çdo temë mësimore që e mundëson kuizi.	 Çka është Microsoft Excel-i? Exceli është një program për kalkulimin e tabelave, i cili është zhvilluar nga kompania Microsoft dhe bënë pjesë në paketën e Microsoft Office. Ekzistojnë edhe lloje të programeve të tjera, të cilat përdoren për kalkulimin e tabelave, mirëpo Exceli mbetet ende programi më i popullarizuar në botë. Përdorimi i Excel 2013 Exceli përdoret kudo që ka numra, jo vetëm në aktivitete që janë të ndërlidhura me financa, por ai përdoret edhe për punë të tjera. Disa nga përdorimet e Excel-it janë: • Përpunimi i numrave • Organizimi i listave • Qasje tek të dhënat tjera • Krijimi i diagrameve

Tabela 11 - Përmbledhje e objektivave

5.3 Paraqitja e përmbajtjeve mësimore duke përdorur teknikat.

Rëndësi të veçantë ka paraqitja e përmbajtjeve mësimore në kurs si dhe teknikat për mësimdhënie, të cilat përdoren në kohën bashkëkohore e që janë të shumta; disa prej tyre në mund t'i aplikojmë edhe në kurs ¹⁴:

- Teknika e demonstrimit praktik,
- Teknika e prezantimit- interpretues,
- Teknika qasje e bazuar në materialin mësimor.


¹⁴ E-learning methodologies A guide for designing and developing e-learning courses

Teknika e demonstrimit praktik

Përmes demonstrimit praktik ne tregojmë se si mund të mesojmë një procedurë apo kryerjen e një funksioni duke treguar hapat e ekzekutimit të procedurës. Praktikimi i kësaj teknike aplikohet në këtë mënyre: fillimisht mësimdhënësi demonstron shembullin dhe u kërkon nxënësve që të përcjellin me vëmendje, ndërsa pas përfundimit të praktikimit nga ana e tij, u kërkon nxënësve ta praktikojnë në kompjuterët e tyre. Nxënësit gjatë praktikimit, mund të kenë ndonjë pengesë, informatë që nuk e kanë kuptuar ashtu siç duhet, dhe mësimdhënësi në këtë rast, duhet të jetë monitorues dhe mentorues. Kjo teknikë është e mundur nëse kemi një kabinet funksional me teknologji informative: lloptop, kompjuter personal, projector dhe qasje në internet.

Shembull: Teknika e demonstrimit praktik

Në shembullin e mëposhtëm është treguar se si mund t'i përdorim temat mësimore gjatë ndjekjes së kursit



Shembull: Teknika e demonstrimit praktik

Në shembullin e mëposhtëm është video e hapur nga nxënësit.




Tabela 12 - Demonstrimi i përdorimit të temave.

Kjo teknikë mund të përdoret për çfarëdo lloj procedure.

Teknika e prezantimit- interpretues

Në këtë teknikë mësimdhënësi interpreton informacione më përmbajtje mësimore, qofshin ato përmes tekstit, një video sekuence apo diqka tjetër. Në vazhdim kemi paraqitur një shembull të teknikës së prezantimit.

Shembull: Teknika e prezantimit-interpretues	
Në këtë mësim prezantohet se si mund të krijohet një libër punues i ri.	Mëso MS Excel 2.. ▾
	LIBRI PUNUES DHE FLETËT PUNUESE...
	Krijimi i librit të ri punues Krijimi i një libri të ri punues në Excel 2013 është plotësisht i ngjashëm me krijimin e fajllit të ri në programet tjera, psh. në Word, por fajlli i krijuar në Excel 2013, ndryshe njihet me emrin e përgjithshëm Workbook (libri punues). Për të krijuar një libër të ri punues në Excel 2013 ndiqni hapat në vijim: Klikoni në regjistrin File Zgjedhni komandën New Zgjedhni Blank Workbook Kliko në butonin Create

Tabela 13 - Forma dhe teknika e prezantimit

Teknika e prezantimit mund të përdoret në rastet specifike kur duhet dhënë sqarime për njësinë që k nxënësit ta kuptojnë më lehtë.

Teknika qasje e bazuar në materialin mësimor

Teknika qasje e bazuar në material mësimor mund të përdoret në rastet kur materialin mësimor e kemi shtjelluar më herët në tema të tjera ,kur disa nga informatat janë të njohura për nxënësit dhe në këtë rast, varet se cilën procedurë ata do të zgjedhin për qëllimin e njëjtë. P.sh hapja e aplikacionit Excel 2013 ka disa mënyra; në këtë rast ne nuk do t'i kushtëzojmë nxënësit se cilën nga

mënyrat do ta përdorin për hapjen e aplikacionit, pasi, si rezultat, na intereson të bëjnë hapjen e aplikacionit.

Shembull: Teknika qasje e bazuar në material mësimor

Në këtë mësim
prezantohet se si
mund të hapet
aplikacioni




Tabela 14 - Teknika qasje e bazuar në materiale

Qasjen e bazuar në materialin mësimor mund ta përdorim në rastet kur:

- Nxënësit bëjnë përsëritjen e materialit mësimor,
- Gjatë kohës së ushtrimeve në cabinet,
- Prezantime të temave të përbashkëta.

Përdorimi i kësaj teknike kërkon një bashkëpunim të madh në mes të mësimdhënësit dhe nxënësve për t'i arritur rezultatet e tyre gjatë ndjekjes së kursit.

5.4 Paraqitja e shembujve

Nxënësit gjatë ndjekjes së kursit do të kenë mundësi të përdorin materiale të formateve të ndryshme sa i përket kursit mbi teknologjinë informative dhe komunikimin me Excel 2013.

Përmes shembujve të paraqitur më poshtë u mundësojmë nxënësve që ta kenë më të lehtë për t'i arritur objektivat dhe qellimet kryesore të kursit.


Shembull	
Përmes këtij shembulli nxënësit mund t'i shohin e marrin materialet mësimore, të cilat mund t'i praktikojnë përgjatë punës me kursin.	

Tabela 15 - Shfrytëzimi i materialit shtesë

5.5 Integrimi i materialit multimedial

Ekzistojnë lloje të ndryshme të funksioneve apo elementeve për të krijuar përmbajtje multimediale. Në kursin tonë do të krijohen përmbajtje, kryesisht multimediale, të cilat mundësojnë arritjen e rezultateve.

Krijimi i përmbajtjeve me tekst ka një rëndësi të veçantë gjatë shtejllimit të temave mësimore, ku është paraparë që përmbajtjet tekstuale të përcillen më foto dhe video.

Përmbajtja e materialit me tekst duhet të ketë parasysh disa elemente gjatë shfaqjes:

- Lexueshmëria dhe qartësia e tekstit gjatë prezantimeve,
- Formatizimi i tekstit, dallimi për funksionet kryesore Bold Italic,
- Prezantimi i përmbajtjeve në vendet më hapësirë të madhe.

Përdorimi i grafikës mund të përfshijë materialet mësimore si fotografi, diagrame e ikona. Përdorimi materialeve grafike luan rol shumë të rëndësishëm në lehtësimin e të mësuarit, duke tërhequr vëmendjen përmes grafikës në një rezultat kryesor.

Organizimi i përmbajtjeve mësimore në formë grafike i motivon nxënësit për të ngritur nivelin e mësimnxënies, stimulojnë hapsirat punuese dhe e bënë më interesant materialin mësimor.

Më poshtë kemi paraqitur një shembull të përmbajtjes mësimore në formë grafike.




Tabela 16 - Përmbajtjet mësimore grafike

Përdorimi i materialit mësimor rrit efektivitetin në kurs, ndërsa krijimi i përmbajtjeve audio mund ta përdorim në kombimin me tekst e foto, të cilat rrisin interesimin e nxënësve për të vazhduar tutje. Përmbajtjet mësimore audio janë më të mira se sa ato tekstuale, sidomos në rastet kur përmbajtjet audio i shoqërojmë me video. Përmbajtjet audio është mirë të jenë sa më të shkurtra, ta zëmë, për të përshkruar një foto apo animacion. Përdorimi i audios me tekst ka një efekt jashtëzakonisht të madh

në mësimnxënie, ku nxënësit, në ndërkohë mund ta përcjellin materialin për aq herë sa të jetë e nevojshme.

Përmbajtja e materialit mësimor me video është shumë e favorshme për të arritur rezultatet e kursit. Materialin përmes videos mund ta përdorim në të gjitha temat dhe shembujt, që do të praktikohen në kurs. Gjatë përcjelljes së materialit mësimor me video kuptohet që interneti duhet të jetë i një shpejtësie më të madhe. Në materialin tonë videot do të përcillen me komentim dhe praktikim të aplikacionit Excel 2013.

Videot, të cilat ndërtohen në kursin tone, përfshijnë materialin mësimor që dalin nga tema apo njësia, teksa nxënësit do të kenë mundësi ta ndjekin kursin në cilëndo kohë.


Shembull: mësimi i organizuar me video	
Ilustrimin në anën e djathtë paraqet një situatë me përmbajtje mësimore me video.	ÇKA ËSHTË MICROSOFT EXCEL-I?  Notes 0 (LIST VIEW) Comments 0 << 00:06 / 02:35 >> Go To: 00:00 240 ch Clear Krij

Tabela 17 - Përmbajtjet mësimore video

5.6 Zhvillimi praktik i kuizit dhe testeve

Rëndësi të veçantë për arritjen e rezultateve të të nxënit kanë hartimi i pyetje për kuize dhe teste. Krijimi i pyetjeve duhet të bëhet në atë mënyrë që të përfshihet tema mësimore tek kuizet, ndërsa tek testet të përfshihen temat e kaluara. Në kursin tonë e kemi paraparë që në fund të çdo teme apo njësie mësimore të ketë një kuiz, i cili në një farë forme synon arritjen e rezultateve të lëndës konkretisht të temën.

Forma e pyetjeve

Organizimi i pyetjeve do të bëhet në forma të ndryshme, që kanë të bëjnë me qasje e opsione direkte në rezultatet mësimore. Format, të cilat përdoren shpesh për kuize të ndryshme e të cilat forma i kemi paraparë që t'i aplikojmë edhe ne në kurs;

- Zgjidhje me shumë opsione – multiple choice,
- Me shumë përgjigje – multiple answers,
- E saktë dhe e pasaktë – True or Fals,
- Përgjigje e shkurtër – Short answer,

Shembull: Forma e Kuizit	
Forma e pyetjeve; zgjidhja me shumë opsione multiple choice	Pikët: 0 / 10 4 Për të zgjedhur një shabllon (template) ☒ a) Klikojm mbi shabllonin përketes (template) ☐ b) Klikojm Blank workbook ☐ c) Klokujm te X-Close
Me shumë përgjigje multiple answers	Pikët: 10 Si bëhet aktivizimi i mënyve? ☐ Duke klikuar mbi mëny ☐ Ctrl+H ☐ Alt+shkronja e mëny ☐ Ctrl+Alt


E saktë dhe e pasaktë True or Fals	Pikët: 10 / 10 3 Microsoft Excel 2013 përdoret për përpunimin e tekstit? ☐ Sakt ☒ Pa sakt ✓
Përgjigje e shkurtër Short answer	Pikët: 10 Tregoni disa nga nënmënyt e menysë File?  Nënmënyt e menysë File janë: new, open, save, save as, print close.....

Tabela 18 - Përzgjedhja e pyetjeve të kursit

Më poshtë kemi dhënë arsyet se pse i kemi përdorur këto forma të pyetjeve në kursin tonë.

Zhgjidhja me shumë opsione **multiple choice** – është e përshtatshme dhe shumë fleksibile për nxënësit, mirëpo gjatë krijimit të saj, kuptohet që mere shumë kohë.

Me shumë përgjigje **multiple answers** – është formë fleksibile, ku nxënësit do të kenë mundësi të zgjedhin dy e më shumë përgjigje.

E saktë dhe e pasaktë **True or Fals** – Nxënësit mund të bëjnë reagim më të shpejtë në përgjigje, poashtu kanë edhe një mundësi prej 50 % për t'iu afuar përgjigjes.

Përgjigje e shkurtër **Short answer** – këto përgjigje krijohen nga nxënësit, ndërsa kontrollohen nga mësime dhënësi.

6. Zhvillimi i kursit

Kursi Excel 2013 do të ndërtohet në platformën eduongo.com duke përdorur mjetet ekzistuese dhe publikimin e tij në internet. Në vazhdim do të japim informacione se si mund të krijojmë përmbajtjet mësimore të kursit në mënyrë interaktive.

Mund të përdorim vegla të ndryshme për të krijuar përmbajtje mësimore, në varësi të organizimit të të dhënave¹⁵.

Organizimi i përmbajtjeve mësimore interaktive (p.sh teksti, ilustrimet, animacionet, audio,video) është bërë në dy mënyra kryesore:

- Përshtatja e mësimi në distancë me specifikimet e kursit, përdorimi i aplikacioneve të ndryshme për të zhvilluar përmbajtje interaktive.
- Të shfrytëzohen mjetet e punës që përmbanë platform e të cilat janë krijuar në mënyrë të posaçme për të zhvilluar përmbajtjet mësimore.

Aplikacionet të cilat i kemi përdorur për krijimin e përmbajtjeve mësimore, kuptohet që kërkojnë një profesionalizëm dhe kohë të mjaftueshme për zhvillimin e tyre. Ndërsa, zhvillimi i përmbajtjeve mësimore duke përdorur veglat e punës në platformën eduongo mundëson përdorimin e tyre edhe nga të tjerët, që nuk kanë përvojë në krijimin e përmbajtjeve mësimore, duke përdorur aplikacione të ndryshme.

6.1 Regjistrimi në kurs

Regjistrimi i nxënësve në kurs mund të bëhet në disa forma, të cilat janë forma e mbyllur dhe forma e hapur e kursit, varësisht nga organizimi i mësidhënësit.

Më poshtë do të tregojmë formën e mbyllur të kursit se si nxënësit mund të regjistrohen.




Figura 5 - Regjistrimi i përdoruesve

Për t'u regjistruar nxënësi në kurs duhet të klikojë **Regjistrohu këtu**, pastaj në figurën e mëposhtme kërkohet kodi i kursit.

¹⁵ www.eduongo.com




Figura 6 - Vendosja e kodit përkatës

Në këtë rast, nxënësit marrin kodin nga mësimdhënësi i tyre dhe pasi që kanë marrë kodin, më poshtë duhet të shtypet butoni **Join Course**, ku më pastaj paraqitet figura e ardhshme.




Figura 7 - Të dhënat kryesore për regjistrim

Në këtë figurë nxënësit që regjistrohen për herë të parë duhet të shtypin butonin **Regjistrohu si nxënës i ri**. Pas plotësimit të formularit të kërkuar për regjistrim, nxënësi fillimisht shënon Email-in dhe pastaj fjalëkalimin, dhe pasi t'i ketë vendosur keto të dhëna shtyp butonin **Hyrje**.

Forma tjetër për të hyrë në kurs është duke klikuar butonin **Hyrje** i cili gjendet në pjesën e sipërme të faqes, në anën e djathtë, ku pasi kemi klikuar butonin **Hyrje**, paraqitet dritarja tjetër, që duket si në figurën në vazhdim.

Hyrje



Excel 2013
Teknologjia Informatike
dhe Komunikimi

Email

Fjalëkalimi

Hyrje

[Keni harruar fjalëkalimin?](#)

[Kthehu mbrapa](#)

Figura 8 - Kycja në kurs

6.2 Organizimi i menysë

Organizimi i menysë bëhet nga veglat e punës, të cilat po i shohim këtu .sh shenja + na mundëson që të shtojmë module ose butona të rinj, të cilët mund t'i përdorim si meny. Në pjesën e mëposhtme shohim se si është organizuar menyja kryesore e kursit. Në fillim po shohim se është vendosur butoni Mësimet dhe Forumi, ku nga këtu nxënësit do të kenë mundësi t'i ndjekin të gjitha mësimet e vendosura në këtë kurs; gjithashtu, do të kenë mundësinë të diskutojnë në forum me nxënësit e tjerë që janë pjesë e kursit si edhe me mësime të tjerë.




Figura 9 - Menyja Kryesore(Tabela kërkuese).

Pjesë tjetër e kursit është edhe organizimi i aktiviteteve që përmban ky kurs si p.sh. detyrat, kuizet e diskutimet për këto aktivitete.

Në pjesën e tretë janë të sistemuara orari, notat, librat, fajllat dhe disa materiale shtesë të organizuara përmes sllajdeve

6.3 Publikimi i materialit mësimor

Publikimi i materialit mësimor është shumë i rëndësishëm prandaj duhet pasur kujdesë gjatë publikimit të tij në kurs, duke pasur parasysh organizimin e përmbajtjes mësimore. Për të publikuar materialin mësimor duhet të shkojmë përmes këtyre hapave:




Figura 10 - Krijimi i moduleve

Hapi 1. Zgjedhim menyn **Mësimet**

Hapi 2. Shtypim butonin **Krijë sesion të ri**

Hapi 3. Shkruajmë **emrin e sesionit**

Hapi 4. Shtypim butonin **Create**

Pasi që kemi krijuar sesionin e ri na paraqitet krijojmë apo vendosim përmbajtjen heret. Përdorimi i veglave të shiritit është i që gjendet në shirit ka funksionin e saj, për të shkurtër për secilën

një shirit punues, me të cilin ne mund të mësimore, të cilën e kemi krijuar më rëndësisë së veçantë, ku secila nga veglat cilat do të japim nga një përshkrim të



Figura 11 - Shiriti punues

Riorganizimi i tekstit, videos apo kuizit.

1. Shtimi i sllajdeve,
2. Shtimi i aktiviteteve,
3. Shtimi i fotografive,
4. Shtimi i audiove,
5. Shtimi i videove,
6. Aktivitete të vjera.

Duke përdorur funksionet që kemi cekur më lart mundësohet që të krijojmë përmbajtje të mira mësimore. Mundësitë e krijimit të përmbajtjeve janë të mëdha pasi shiriti me vegla na mundëson që t'i përdorim të gjitha veglat nëse është e nevojshme përbrenda një përmbajtjeje mësimore. Në kursin tonë është paraparë që të përdoren më së shumti vegla për shtimin e videos, shtimin e tekstit, shtimin e fotografive dhe aktiviteteve të ndryshme.

Përmes një shembulli më poshtë do të tregojmë se si mund të bëhet vendosja e tekstit në kursin tonë duke e treguar përmes figurës.




Figura 12 - Vendosja e materialit mësimor me tekst

Shkruajmë titullin e temës

1. Tek opsioni i dyte shënojmë titullin, në rast se duam ta kërkojmë më vonë.
2. Faqja punuese ku ne mund të vendosim tekstin.
3. Shiriti i veglave, të cilat mund t'i përdorim për formatizimin e tekstit.
4. Të anulojmë ndryshimet e bëra.
5. Ta ruajmë përmbajtjen mësimore për ta pasur në listën e mësimave në kurs.

Përmes një shemublli më poshtë do të tregojmë se si mund të bëhet vendosja e fotografisë në kursin tone, duke e treguar përmes figurës.

→ 1 **IMAGE (PUNA ME RRESHTA DHE KOLONA)** X

Give your container a unique name that will help you identify it later, and will help you re-arrange your containers easier.

puna me rreshta dhe kolona 2 ←

→ 5 Anuloje Ruaj

Attach a Image

Choose File <http://d1u15t5g0hmgd.cloudfront.net/44372/16.jpg> Image 3 ←

Description:

B I U Styles Format Font Size 4 ←

ne figuren e mesiperme kemi paraqitur se si mund ti perdorin rreshtat dhe kolonat

Figura 13 - Vendosja e materialit mësimor me fotografi

1. Titulli i fotografisë.
2. Tek opsioni i dyte shënojmë titullin, në rast se duam ta kërkojmë më vonë.
3. Zgjedhim opsionin **Choose File** për të insertuar fotografinë.
4. Përshkruajmë fotografinë dhe e bëjmë formatizimin e tekstit.
5. Anulojmë ose ruajmë insertimin e fotografisë.

Përmes një shemublli më poshtë do të tregojmë se si mund të bëhet vendosja e videos në kursin tonë, duke e treguar përmes figurës.

VIDEO X

Give your container a unique name that will help you identify it later, and will help you re-arrange your containers easier.

Hyrje Excel 2013 Anuloje Ruaj

Add a video by pasting the URL from YouTube or Vimeo. You can also upload an MP4 video file from your computer, EDUonGo storage, Google Drive, or Drop Box.

Choose Layout: [Layout Icons]

+ Shto Video 1

--- Përzgjedh Videon --- 4

→ 5 Anuloje Ruaj

Figura 14 - Vendosja e materialit mësimor me video

Për të shtuar përmbajtje mësimore me video është pothuajse e njëjta porcedurë sikurse instertimi i fotografive, dallon vetëm në disa opsione p.sh. pasi kemi shtypur butoni **+Shto Video** na paraqitet figura si në vazhdim.




Figura 15 - Vendorsja e videove në kurs

- Te opsioni i parë mund të zgjedhim video të cilat i kemi krijuar më herët dhe i kemi publikuar ato në internet.
- Te opsioni i dytë mund t'i kërkojmë videot e publikuara përmes emrit, pastaj shtypim butonin **Kërko**.
- Te opsioni i tretë zgjedhim videon e kërkuar.
- Te opsioni i katërt bëjmë shtimin e videos ose anulimin e saj përmes butonit **Add Video** ose **Anuloje**.

7. Implementimi i kursit për mësim në distancë

Kursi Excel 2013 është zhvilluar me qëllimin kryesor për t'u ofruar nxënësve mësim online nga informatika. Kursi përmban diku rreth trembëdhjetë tema kryesore, të cilat janë kryesore në excel dhe të nevojshme që të mësohen nga nxënësit. Disa nga temat mësimore që mësohen në këtë kurs janë të njohura për përdoruesit dhe synimi i tyre, në një farë forme është, që t'i plotësojnë kuizet dhe të testojnë veten e tyre, ndersa një pjese tjeter përcjellin të gjitha temat në formën e rregullt. Përpiluesit e platformave kanë krijuar një opsion, i cili bënë navigimin e përdoruesve të kursit për materialin mësimor, që klientet në njëfarë forme detyrohen të përcjellin përmbajtjet mësimore me rregullat e kursit.

Zbatimi i teknologjive të informacionit për mësim në distancë kërkon një planifikim të veçantë dhe të kujdesshëm njëkohësisht. Më poshtë përmes figurës kam paraqitur procesin e implementimit të kursit.



Figura 16 - Forma e implementimit

7.1 Nevojitet kryerja e vlerësimeve

Në këtë fazë të të vlerësimit ose analizës së nevojave, analiza përbëhet nga katër pjesë:

- Analiza e kursit,
- Analiza e audiences,
- Analiza e mësimdhënësit të kursit dhe
- Analiza teknologjike.

Analiza e kursit

Analiza e kursit synon që të rrisë të mësuarit nga kompjuteri, duke shqyrtuar nevojat mësimore tradicionale, të cilat nuk janë duke i përmushur nevojat e të mësuarit, ku si kontribut në rritjen e cilesisë në të mësuarit është edhe mësimi në distancë. Fushat e ndryshme, sot posedojnë materialet të ndryshme mësimore në internet, mirëpo të paorganizuar mirë dhe joprofesional, ku si kërkesë e parë nga përdoruesit është edhe shfrytëzimi i kurseve online në mënyrë të drejtë¹⁶.

Analiza e audiencës

Format e të mësuarit në distancë mund të mos jenë të përshtatshme për të gjithë përdoruesit; në raste të ndryshme motivimi dhe atësia për të mësuar në një mjedis të vetëm janë adekuate dhe thelbësore për arritjen e rezultateve. Organizimi i kursit me nxënës ka shumë rëndësi, duke iu përshtatur stilit të tyre për të mësuar, sepse ka një dallim të madh mes mësimdhënies tradicionale dhe asaj bashkëkohore, që e ofron kursi? A i kanë materialet e nevojshme në kurs? A duhet të ju jepen këshilla rreth kursit?

Analiza e mësimdhënësit të kursit

Përveç përkujdesit ndaj përmbajtjes mësimore dhe avansimit të materialit si edhe përshtatjes së kërkesave të përdoruesve, mësimdhënësi duhet të jetë i sigurtë në funksionimin dhe menagjimin e kursit, qoftë nga ana e tij apo ndonjë administratori¹⁷. Gjithnjë duhet të sigurohet se kursi është duke funksionuar mirë dhe ka mbështetjen e plotë për përdoruesit e tij nga ana e mësimdhënësit dhe stafit të kursit, nëse është i zgjeruar me menagjues të tjerë. Nëse mësimdhënësi organizon një videoconference, do të sigurohet, fillimisht, për informacionin e zhvillimit të saj, datën, kohën dhe njoftime të tjera, dhe paraprakisht duhet të testojë funksionalitetin e paisjeve.

¹⁶ 11 de Rosa C., FAO's Reference Manual on 'Good learning practices for effective capacity development'. Learning Module 3 of the Capacity Development Learning Programme series, Office of Knowledge and Capacity for Development (OEKC), FAO 2011.

¹⁷ 13Clark R.C., Mayer R.E., e-Learning and the Science of Instruction - Proven Guidelines for Consumers and Designers of Multimedia Learning, Second Edition, Pfeiffer 2005

Analiza teknologjike

Kursi mund të përdoret nga teknologji informative të ndryshme, ku përzgjedhjen për përdorimin e kursit e bëjnë vetë nxënësit, varësisht prej stilit tyre të të mësuarit. Meqë materiali mësimor është i ndërtuar edhe me audio e video, teknologjia më e mirë për të mësuar në këtë rast do të jetë mësimi nga kompjuteri.

6.2 Synimet dhe objektivat mësimore

Për të pasur një kurs për mësim në distancë sa më efektiv, ai duhet të përmbajë disa rezultate ose objektiva mësimore për t'i arritur ato nga përdoruesit. Në rastin e kursit Excel 2013, në një farë forme objektivat janë paraqitur përmes kuizeve, të cilat janë të vendosura në çdo temë mësimore, ku me plotësimin e kuizeve në formë të saktë kuptojmë se janë arritur disa nga rezultatet e pritura ose objektivat kryesor të kursit. Në kursin Excel 2013 është ofruar një metodë e mirë e materialit mësimor; organizimi, strukturimi dhe funksionalizimi i tij për të arritur sa më lehtë objektivat e kursit.

6.3 Trajnimi i përdoruesve

Ekzistojnë shumë metodologji dhe teknika të mësimdhënies, përdorimit të tyre dhe zbatimit në klasë apo kurse online. Përdoruesve të kursit duhet t'u ofrohet një material se si mund të përdoret kursi në formën më të mirë të mundshme. Dallon të mësuarit në klasë, shkollë dhe të mësuarit online nga interneti. Meqë kursi do të jetë online dhe i hapur për të gjithë, mundësitë për t'i trajnuar të gjithë përdoruesit do të jenë paksa të vështira, dhe kështu në këtë formë në kapitullin e ardhshëm do të tregojmë se si mund të përdoret kursi Excel 2013. E rëndësishme është që nxënësit të jenë të integruar në kurs, ku më pas janë mundësitë e komunikimit me mësimdhënësin dhe nxënësit e tjerë përmes forumit apo mesazheve online dhe përdorimit të emailit.

6.4 Testimi i kursit

Në fillim do të bëhet një lloj pilotimi i kursit me 10 nxënës, të cilët do të kenë mundësi të regjistrohen në kurs pasi që mësimdhënësi i kursit u ka dhënë kodin për qasje në kurs. Gjatë fazës së pilotimit do të sigurohemi që përdorimi i teknologjisë informative është duke funksionuar dhe më pas të vërtetojmë se kursi mund të zbatohet dhe të jetë i hapur edhe për gjithë të tjerët, që duan të ndjekin kursin Excel 2013. Këta 10 nxënës do të kenë mundësinë të mbajnë kontakte të drejtëpërdrejta me mësimdhënësin e kursit dhe të bëjnë kërkesa e tyre çfardo qofshin ato, ku mësimdhënësi duhet të shqyrtoj çdo kërkesë që nxënësit e kanë, me qëllimin më të mirë për të arritur objektivat e kursit¹⁸.

¹⁸ http://tik-10.eduongo.com/v2/desktop/app/settings/list_vieë

8.0 Shpërndarja e informacioneve

Aktivitetet mësimore në kurs janë vendimtare para se të shpërndahen online, sepse nga këto aktivitete symojmë të arrim cilësinë dhe efektivitetin e kursit, dhe edhe në rast të ndonjë lëshimi të vogël, synimi ynë është që aktivitetet e ardhshme të jenë sa më të mira dhe profesionale. Në rastet kur bëjmë shpërndarjen e informacioneve në kurs, duhet të jemi të sigurtë që përmbajtja mësimore të jetë porfesionale, sepse synimi jonë është që kursi të jetë i hapur për të gjithë nxënësit që duan të mësojnë Excel 2013.

Karakteristikat e DESKTOP-it

Desktopi është një opsion nga ku ju mund të menagjoni kurset, përdoruesit, përmbajtjet, fotografitë

- | | | |
|-------------------------|--------------------|---------------------|
| ◆ Kurset | ◆ Admin Raportet | ◆ Katalogu i kursit |
| ◆ Menagjimi përdoruesve | ◆ Librat e mi | ◆ Website |
| ◆ Konfigurimet | ◆ Temat | ◆ Vizatimet |
| ◆ Profili im | ◆ Dokumentet e mia | ◆ Muri im |
| | | ◆ Përkthimet |

dhe opsione të tjera. Çdo dritare përbrenda desktopit ka titullin dhe opsionet e veta, të cilat i kemi prezantuar më poshtë.

Kurset

Te dritarja “kurset”, administratori mund të krijojë kurse të ndryshme dhe t’i organizojë ato në departamente dhe fusha të ndryshme me lëndë përkatëse.

Organizimi dhe prezantimi i kurseve mund të bëhet në tri forma e ato janë:

FALAS – i hapur për të gjithë,

ME PAGESË – paguaj një tarifë për të ndjekur kursin,

MBYLLUR – hynë duke përdorur kodin për qasje në kurs.

Kurset mund të klonohen dhe të ndahen në mës fushave ose mes akademive të ndryshme.

Menagjimi përdoruesve

Këtu, administrator dhe mësimdhënësi i kursit mund të shtojnë ose të largojnë përdoruesit e kursit, mund të ndryshojnë rolin e përdoruesit, emrin, mbiemrin, emailin apo edhe të rikthejnë fjalëkalimin e përdoruesit.

Konfigurimet

Këtu përdoruesit mund të bëjnë disa ndryshime në llogari të tilla si domain name akademi ndryshimin në kohë - si Time Zonë, e opsione të tjera.

Profili im

Këtu përdoruesit mund të ngarkojnë fotografite e profilit të tyre përbrenda platformës eduongo, mund të ndërtojnë edhe një biografi “CV” rreth vetes së tyre. Gjithashtu, kursin mund ta lidhin edhe me llogaritë e tyre në rrjetet sociale, mund të menagjojnë fjalëkalimin e tyre për qasje në kurs etj.

Admin raportet

Raportet mund të përdoren vetëm nga mësimdhënësit dhe administruesit e kursit dhe këtu mund të shihen raportet si; aktivitetet e nxënësve, kurse, detyra, kuize dhe diskutime.

Librat e mi

Këtu nxënësit mund të shohin librat e publikuar nga mësimdhënësi i kursit apo administratori i kursit që inkurajojnë bashkëpunimin në mes të nxënësve, në kontekstin e një libri elektronik E-Book. Librat gjatë publikimit kalojnë nëpër një proces të thjeshtë, të cilin administratori i kursit duhet ta miratojë.

Dokumentet e mia

Përdoruesi mund të organizojnë dokumentet e tij. Hapësira e ofruar nga eduongo është 2GB e lirë, por mund të integrohet edhe me Google Drive. Përdoruesit mund të krijojnë dosjet e tyre.

Temat

Administratorët mund të ndryshojnë pamjen e kursit, duke i bërë përshtatjen për fushën e caktuar; mund të ndryshojë logon, ngjyrat si dhe imazhin e sfondit me skemën e tyre të preferuar.

Katalogu i kursit

Administratori mund të ndryshojë informacionet, të cilat paraqiten në katalogun e kursit në hyrje të tij. Opsionet përfshijnë: fotografi, titullin e kursit, emrin e mësimdhënësit dhe numrin e pjesëmarrësve.

Website

Këtu ju mund të zhgjidhni se cila nga opsionet të paraqitet në hyrje të faqes p.sh Katalogu i kursit apo Login faqja.

Vizatimet

Këtu është një aplikacion ku ju mund të bëni disa vizatime dhe atom und, t'i ruani si fajlla imazhe.

Muri im

Është një vend i centralizuar ku ju mund të shihni të gjitha veprimet në të gjitha kurset tuaja, e që mundëson një komunikim më të lehtë me përdoruesit e të gjitha kurseve. Nga këtu ju mund të jepni një informatë për të gjithë përdoruesit në kurset tuaja të ndryshme, duke ju dhënë mundësinë të gjithë përdoruesve për të komunikuar.

Përkthimet

Nga ky opsion administratori i kursit mund të bëjë përkthimin e të gjitha opsioneve përbrenda kursit në çfarëdo gjuhe që ju dëshironi.

Përparësitë dhe përfitimet

Eduongo është një platformë e avansuar për të mësuarit në distancë. Në platformat tjera nuk është e lejuar që të kopjohen kurset. Kurset në eduongo lejojnë një efikasitet të paparë në shpërndarjen e përmbajtjeve dhe lëhtësimin e proceseve të të mësuarit. Nxënësit mësojnë në forma të ndryshme me eduongo; nxënësit mund të vendosin rrugën e tyre më të lehtë për të mësuar dhe përfunduar kurset me sukses. Evaluimi I kursit në përgjithësi është paraparë që të realizohet përmes numrit të përdoruesve¹⁹, dhe pyetësorëve²⁰.

8.1 Krahësimi i platformave

Eduongo është një platformë innovative, e cila është e lehtë për t'u menaxhuar dhe mësuar, kurse me fushat dhe lëndët e ndryshme ofron një bashkëpunim efektiv, të mirë të ndërsjellë për mësimdhënësit dhe nxënësit që ndjekin kurset.

Karakteristikat	EDUonGo	Canvas	E-edukimi
Të gjitha mjetet për një LMS për të drejtuar dhe menagjuar një shkollë në internet: • Mjetet e administratorit • Ndërtimi i kursit dhe menagjimi • Detyra, kuize, diskutime, vlerësimi.	PO	PO	PO

¹⁹ 43Kirkpatrick D.L. and Kirkpatrick J.D. (2006). Evaluating Training Programs. The Four Levels. San Francisco: Berrett-Koehler Publishers.

²⁰ 44A fifth level of Kirkpatrick's evaluation model, the Return on Investment (ROI), has been introduced by Jack J. Phillips. According to Phillips, the ROI is a comparison between benefits and costs: ROI = Net Programme Benefits/ Programme Costs. See J.J. Phillips (1997). Return on Investment in Training and Performance Improvement Programs, Gulf Pub Co

Aktivizimi i kursit në një minutë	PO Me eduongo ju mund të krijoni një kurs në një minutë onlin, të cilin ju mund ta shisni për klientët tuaj. Eduongo ofron një sistem të integruar për pagesat e mësimdhënësve që krijojnë kurse.	PO	JO
Temat bazike	PO Eduongo konsiderohet si një platformë jashtëzakonisht e mirë për arsimimin e brezave	PO	PO
eBook kompozer & lexues	PO Eduongo ka ndërtuar eBook kompozer ku mësimdhënësit dhe nxënësit mund të vendosin së bashku librat e tyre; eBook lexuesit mund të ndajnë materialin me të tjerët. Publikuesit e librave elektronik mund të insertojnë edhe materiale interaktive me video përbrenda faqes.	PO	JO
Karakteristikat	EDUonGo	Canvas	E-edukimi
Krijimi i përmbajtjeve kreative	PO Eduongo aktivizon	PO	JO

	mësimdhënësit duke përdorur mjetet për të krijuar përmbajtje mësimore interactive, të cilat janë të mirëpritura nga përdoruesit. Përmbajtje “krecreativend” të kemi në rastet kur na mundësohet që të përdorim tekst, foto, video e shumë lloje të tjera.		
Shabllonet e kurseve në treg	PO Mësimdhënësit mund të krijojnë kurset dhe t’i shesin ato në publik ose t’i përdorin për çështjet e brendshme - dedikuar vetëm shkollës së tyre.	JO	JO
Karakteristikat	EDUonGo	Canvas	E-edukimi
Bashkëpunues në të mësuarit			
Rrjedhat e kursit	PO Eduongo është i lidhur ngusht edhe me rrjetet sociale si facebook. Qdo kurs ka hapësirën e shtrirjes së tij, ku përdoruesit mund të bëjnë share apo të komentojnë, diskutojnë për kurset dhe mësimet e tyre.	JO	JO

Përmbajtjet me video	PO Nxënësit dhe mësimdhënësit mund të bashkëpunojnë duke i shikuar mësimet me përmbajtje video; në të njëjtën kohë mund edhe të komentojnë apo të diskutojnë për videot përkatëse.	PO	JO
Integrimi i palës së tretë			
Mjetet Microsoft	PO Eduongo ka të integruar OneDrive, OneNote dhe Office Mix. Përdoruesit mund ta lidhin llogarinë e tyre me OneDrive akont. Me një klikim në buton, nxënësit dhe mësimdhënësit mund të ndjekin mësimet e tyre.	JO	JO
Lidhshmeri dhe komunikime të ndryshme	PO Përdoruesit mund të bëjnë lidhshmëri të ndryshme si p.sh nga rrjeti social facebook mund të logohen në kursin e tyre apo edhe të njëjtin ta bëjnë publik me të tjerët.	JO	JO

Tabela 19 - Krahاسimi i platformave

Në bazë të hulumtimit me nxënës, del se ata kanë vlerësuar se platforma eduongo është më e përshtatshme për përdoruesit e kurseve, në krahasim me E-edukimin dhe Canvas, për shkak se eduongo ofron një punë më të lehtë për ndjekjen e kurseve sesa dy platformat e tjera. Fillimisht, marrim për shembull, organizimin e përmbajtjeve mësimore përbrenda një kursi, ku dukshëm më lehtë është për të punuar në platformën eduongo, për shkak se organizimi i përmbajtjeve mësimore vendoset përbrenda një faqeje. Dallime të tjera në mes të platformave janë se në canvas mund të organizohen kuizet me kalueshmëri apo se mund të vendosim pragun për të kaluar kuizin. Në rast se nuk kalohet kuizi, ai mund të përseritet pas një kohë.

Më poshtë kemi paraqitur statistikën e hulumtimit përmes një grafiku, në atë se cila nga platformat është më e përshtatshme për përdorim të kurseve online.

Krahasimi i platformave			
Vlerësimi në kërkesa	e-edukimi	eduongo	canvas
Përmbajtja e kursit ofron një qasje të re dhe kreative	19	49	18
Dizajni dhe struktura e kursit ishte e qartë	22	53	22
Sa është efektiv për t'i arritur qëllimet, objektivat e të nxënës	13	10	6
Sa jeni të kënaqur me kursin në përgjithësi	25	57	22
Sa është i lehtë kursi për ta përdorur	17	33	11
Sa jeni të kënaqur me organizimin e kuizeve	17	42	18

Tabela 20 - Statistikat e krahasimit të platformave




Figura 17 - Grafiku i statistikave

8.2 Planifikimi i aktiviteteve dhe dokumentimi

Për të pasur një kurs të mire, atëherë duhet të kemi edhe një planifikim dhe dokumentim të aktiviteteve, që e lehtëson punën e mësimitdhënësit për të menagjuar më mirë kursin. Dokumentimi në një farë forme është edhe lloj udhësuesi për zbatimin e aktiviteteve, të cilin mund ta shpërndajmë edhe tek përdoruesit e kursit.

Te planifikimi, kuptohet që duhet të kemi planprogramin dhe rezultatet e të nxënit për kursin. P.sh

Shembulli i një planprogrami mësimor

Planifikimi

Dhjetor 2015

Mëso MS Excel 2013

Linku i Kursit: https://tik-10.eduongo.com/v2/website/web/course_catalogue

Në këtë web faqe ju mund të mësoni aplikacionin e Excel 2013. Fillimisht ju duhet të rexhistroheni si përdorues i ri dhe të vazhdoni kursin me kushtet dhe rregullat e kursit.

Mësimdhënësi Kursit: Kudret Rexhepi
Zyre: +344 44 922 745
Email: kr07375@seeu.edu.mk
Orari: E Mart 8:00 – 10:00

Rreth Kursit

Të dashur nxënës, në këtë klasë do të mësoni rreth Microsoft Excel 2013. Duke pasur parasysh versionet e paketit të microsoft office, ne ju mundesojm që ju të mesoni kursin e Microsoft Excel 2013 në klasës 10-të. Për ta bërë lëndën e TIK-ut më interesante, më atraktive dhe më lehtë të kuptueshme do të përdorim përmbajtje mësimore përmes tekstit fotografive, animacione, video dhe praktika të ndryshme.

Detajet e Kursit

Në vazhdim po japim temat të cilët do t'i shtellojmë gjatë mësimit të TIK-ut në këtë klasë.

- Hyrje - Cfare është Microsoft Excel dhe për cfare përdoret
- Dritarja e Excel-it dhe Përdorimi i menysë
- Libri Punues dhe fletët punuese

Tabela 21 - Planifikimi I Planprogramit mësimor

Duke pasur parasysh që çdo seancë e organizuar në kurs i ka rezultatet dhe objektivat që synohen të arrihen nga mëimdhënësi, atëherë një planifikim i mirë do të na kishte mundësuar që t'i arrim ato rezultate dhe objektiva të kursit.

Në tabelen e mëposhtme është paraqitur organizimi i temave në kurs.

Titulli	Temës e pare; Hyrje në Microsoft Excel 2013
Koha	16 dhjetor 2015
Pjesa e parë e përmbajtja me tekst dhe fotografi.	Çka është Microsoft Excel-i? Exceli është një program për kalkulimin e tabelave, i cili është zhvilluar nga kompania Microsoft dhe bën pjesë në paketin e Microsoft Office. Ekzistojnë edhe lloje të programeve të tjera, të cilat përdoren për kalkulimin e tabelave, mirëpo Exceli mbetet ende programi më i popullarizuar në botë. Startimi dhe përfundimi i programit të Excel 2013 Ekzistojnë mënyra të ndryshme për startimin e Excel 2013: Shtypim butonin Sart  dhe klikojmë në All Programs Microsfot Office Microsoft Excel 2013, në sistemin operativ
Pjesa e dytë; materiali me video.	 Çka është Microsoft Excel-i? VIDEO
Pjesa e tretë, kuizi parë.	 Kuizi 1 - Hyrje ne Excel 2013

Tabela 22 – Organizimi i seancës së parë

8.3 Lehtësimi i aktiviteteve të nxënësve

Kursi ka një fleksibilitet për të gjithë përdoruesit që kanë mundësi të komunikojnë në mes vete përmes menysë së diskutimeve, apo ndryshe, përmes forumit, ku secili nxënës ka të drejtë të diskutojë rreth kursit. Në të njëjtën, kohë gjatë çdo aktiviteti që bëjnë nxënësit në kurs e kanë mundësinë që të komunikojmë përmes qatit për t'u lehtësur aktivitet e tyre. Të mësuarit në grup krijon mundësi të reja për arritjen e rezultateve të parapara. Për të pasur një lehtësim edhe më të

madh për nxënësit, që janë të regjistruar në kurs, mësimdhënësi duhet t'ju përmbahet edhe disa pikave, të cilat i kemi përmendur më poshtë:

- Shpërndan informacione për detyrat,
- Kontrollon punën individuale të secilit nxënës në kuiz,
- Motivon nxënësit që pjesëmarrja e tyre të jetë në nivel të lartë në kurs.

8.4 Vlerësimi i kursit

Vlerësimin e kursit e bëjmë për të parë efektivitetin e tij, mirëpo vlerësimi duhet të bëhet në disa faza të ndryshme të kursit:

- Në fazën e zhvillimit, për t'i përmirsuar përmbajtjet mësimore e kuizet videot,
- Në fazën e implementimit bëjmë një vlerësim përmbledhës,
- Pas publikimit të kursit apo edhe gjatë zbatimit të tij bëjmë një vlerësim përmbyllës, duke i përmirësuar të dhënat në kurs.

Një vlerësim tjetër mund ta bëjmë duke vendosur një lloj pyetësori mbi atë se sa jeni të kënaqur me kursin dhe disa pyetje të tjera që kanë të bëjnë, në përgjithësi, me kursin e që na mundësohet të marrim një vlerësim nga nxënësit.

8.5 Përdorimit i kursit në platformën EduonGo,_Canvas dhe E-edukimi

Do të tregojmë se si përdoruesit mund të përdorin kursin tonë Excel 2013 në platformën eduongo²¹. Fillimisht përdoruesit duhet që të kenë qasje në internet, pastaj të hapin broëserin dhe të shënojnë domain name: tik-10.eduongo.com, ku ju paraqitet figura e mëposhtme. Nëse përdoruesit janë të regjistruar më herët në kurs, mund të shtypin butonin **Hyrje**, i cili gjendet në anën e majt - lart dritares.

²¹ <http://eduongo.com/academy>




Figura 18 - Përzgjedhja e kursit

Për tu regjistruar si përdorues i ri, shtypim kursin “mëso MS Excel 2013”, i cili gjendet në anën e majtë, në fund të faqes.



Figura 19 - Hyrje për regjistrim

Pasi të shtypim butonin **regjistrohu këtu**, na paraqitet dritarja tjetër ku mund të **regjistroheni si nxënës i ri**.




Figura 20 - Regjistrohu si nxënës i ri

Pasi të keni shtypur butonin regjistrohu si nxënës i ri, ju në vazhdim duhet t'i vendosni të dhënat kryesore për t'u regjistruar në kurs.




Figura 21 - Krijo përdoruesin

Të dhënat e nevojshme për t'u regjistruar në kurs janë emri dhe mbiemri, pastaj email adresa, fjalëkalimi prej gjashtë simboleve dhe krejt në fund, për të krijuar përdorues të ri, shtypim butonin **Sing Up**.

Pasi të kemi krijuar përdorues të ri, ne mund të shtypim butonin për **hyrje**, i cili gjendet ne anën e majtë - lart.




Figura 22 - Hyrja në kurs

Pastaj, këtu shënojmë email-in dhe fjalëkalimin dhe shtypim butonin **Hyrje**, ku më pas do të na shfaqet Desktopi i kursit²².




Figura 23 - Desktopi i kursit

²² <https://tik-10.eduongo.com/v2/desktop/desktop/login/>

Në këtë rast e shohim desktopin e kursit me login të administratorit, ndërsa desktopi për përdoruesit do të përmbajë disa nga opsionet që po shohim më lart. Të gjithë përdoruesit e kursit e kanë të shfaqur dritaren e kursit, dhe për të vazhduar me mësim dhe hapat tjerë, duhet të shtypim dritaren Kurset²³.




Figura 24 - Pamja fillestare e kursit

Në anën e majtë është menyja kryesore e kursit, duke filluar me butonin e parë për mësimet, kuizet, diskutimet për mësimet dhe kuize, pastaj orari i mësimetve, notat, librat për kurs etj. Me renditje, duke filluar nga numri 1, 2, 3,...12, 13 janë të sistemuara temat mësimore, dhe për t'i hapur ato duhet të klikojmë mbi temën përkatëse. Le të hapim temën e parë mësimore **Hyrje – Çfarë është Microsoft Excel dhe për çfarë përdoret?**

²³ <http://tik-10.eduongo.com/v2/desktop/desktop/home/>

EDU Session - View

tik-10.eduongo.com/v2/course-26718/session/view/65204

Excel 2013
Teknologjia Informatike dhe Komunikimi

Mëso MS Excel ...

HYRJE - CFARË ËSHTË MICROSOFT ...

NEXT

Çka është Microsoft Excel-i?

Exceli është një program për kalkulimin e tabelave, i cili është zhvilluar nga kompania Microsoft dhe bënë pjesë në paketin e Microsoft përdoren për kalkulimin e tabelave, mirëpo Exceli mbetet ende programi më i popullarizuar në botë.

Përdorimi i Excel 2013

Exceli përdoret kudo që ka numra, excel-i përdoret jo vetëm në aktivitete që janë të ndërlidhura me financa, por ai përdoret edhe për p

Disa nga përdorimet e Excel-it janë:

- Përpunimi i numrave
- Organizimi i listave
- Qasje tek të dhënat tjera
- Krijimi i diagrameve

Startimi dhe përfundimi i programit të Excel 2013

Egzistojnë mënyra të ndryshme për startimin e excel 2013:

1. Shtypim butonin **Start** dhe klikoni në All Programs Microsoft Office Microsoft Excel 2013 në sistemin operativ hapjes së excel 2013 edhe në sistemin operativ Windows 8 i paraqitur në figuren e mëposhtme.



Figura 25 - Përmbajtja e temës mësimore me tekst dhe fotografi

Përmbajtja mësimore me tekst dhe fotografi

Pasi të kemi lexur dhe praktikuar temën mësimore përmes tekstit dhe fotografive, është edhe një mundësi shtesë që të njëjtën temë ta ndjekim në mënyrë vizuale përmes audios dhe videos. Për të startuar videon, shtypim butonin **Çfarë është Microsoft Excel-i? Video**.

ÇKA ËSHTË MICROSOFT EXCEL-I? VIDEO




Figura 26 - Përmbajtje vizuale

Kjo është një nga mundësitë e arta për të mësuar online përmes përmbajtjeve mësimore me audio e video. Në fund të çdo teme mësimore është vendosur edhe një kuiz, i cili shpërben për të testuar rezultatet e arritura nga tema mësimore. Për të startuar kuizin duhet të shtypim butonin **Kuizi 1 – Hyrje në Excel 2013**, dhe më pas të shtypim butonin **Fillo Kuizin**.

KUIZI 1 - HYRJE NE EXCEL 2013

Pyetjet 2 of 5

Pikët: 10

2. Si bëhet lëshimi në punë i Excel 2013 te sistemi operativ Windows 7?

- ☐ a) Start>All Programs>Microsoft Word
- ☐ b) Start>All programs>Microsoft Office>Excel 2013
- ☐ c) Start>Programs>Paint

Next

Figura 27 - Plotësimi i kuizit

Për secilin kuiz janë përgaditur nga pesë pyetje, për të cilat pasi që të kemi dhënë përgjigjen e parë shtypim butonin **Next** për të vazhduar më pyetjen tjetër...; pasi që t'i kemi përfunduar përgjigjet, duhet të shtypim butonin **Submit**, dhe për të parë rezultatin e kuizit duhet të klikojmë te menyja kryesore butonin **Nota** dhe shohim rezultatin e fituar.

GRADE ITEM	GRADE	GRADE RANGE	PERCENTAGE	FEEDBACK	RESULT
Kuizi 1 - Hyrje ne Excel 2013	50.00	0.00 - 50.00	100.00%		View Result
				Final Grade:	100% (A+)

Figura 28 - Vlerësimi i kuizeve

Përdorimi i kursit në platformën E-edukimi është paraqitur përmes një videoje²⁴.




Figura 29 - E-edukimi video

Përdorimi i kursit në platformën Canvas është paraqitur përmes një videoje²⁵.




Figura 30 - Canvas video

²⁴ E-edukimi.rks-gov.net

²⁵ canvas.instructure.com/login/canvas

Shtojca

Lënda e hulumtimit

Përdorimi i kompjuterëve në mësimdhënie, sjell arritjen e kompetencave-rezultateve të planifikuara në fusha të ndryshme, duke pasur parasysh zhvillimin profesional dhe orientimin në karrierë të nxënësve. Integrimi i teknologjisë informative dhe komunikimit për mesim në distancë nuk është vetëm një mundësi për të përparuar, por edhe një domosdoshmëri për ta bërë procesin e edukimit më atraktiv dhe tërheqës. Lënda e hulumtimit është bazuar që të gjejnë një rezultat; atë se sa e përdorin teknologjinë informative - “mësimin në distancë” nxënësit në shkollën tonë. Kursi që është përdorur për mesim në distancë është Excel 2013.

Qëllimi i hulumtimit

Objektivat e hulumtimit kanë të bëjnë me grumbullimin e informacioneve rreth përdorimit të mësimin në distancë nga nxënësit e shkollave të mesme, dhe me qëllim të rezultatit sa më të mirë në hulumtim kam shfrytëzuar pyetësin, i cili është plotësuar nga vetë nxënësit, që kanë ndjekur kursin online. Si parim kryesor në këtë hulumtim është parashikuar kontributi i mësimin online në rezultatet e të nxënës të lëndës mësimore dhe përdorimit të teknologjisë informative dhe të komunikimit si dhe shfrytëzimi i internetit. Poashtu, qëllimi i hulumtimit është që të promovojë të mësuarit në distancë përmes një klase virtual, e cila mundëson që shfrytëzuesit të përcjellin materialet mesimore online.

Detyrat e hulumtimit

Për të arritur qëllimin e hulumtimit kemi zgjedhur disa detyra:

- Të analizojmë dhe të studiojmë tri platforma për kursin Excel 2013.
- Të identifikohet masa e përdorimit të mësimin në distancë,
- Të mbledhen dhe shqyrtohen informacione përmes anketave,
- T’i përpunojmë të dhënat dhe materialet e grumbulluara,
- T’i shfaqim të dhënat në formë grafike,
- T’i komentojmë rezultatet e hulumtimit.

Teknika e hulumtimit

Metoda, respektivisht teknika që kam përdorur në këtë hulumtim janë metoda krahasuese, ku të dhënat kryesore janë nxjerr nga pyetësorët e vendosur në tri platformat kryesore, duke përfshirë arsyeshmërinë e hulumtimit, pastaj një përshkrim të përgjithshëm mbi zhvillimin e kurseve, krahasime dhe avansimi të teknologjise së informacionit dhe komunikimit.

Rezultati i hulumtimit

Rezultati esencial i hulumtimit ka dalur nga anketa me nxënës, respektivisht nga pyetësori. Qëllimi i këtij pyetësori është që të analizohet shfrytëzimi i teknologjisë informative për mësim në distancë. Çështjet që janë trajtuar përfshinë: përdorimin e platformave të reja për mësim në distancë, shfrytëzimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, pjesëmarrjen e nxënësve në ligjërata dhe teste online etj. Në hulumtim kanë marrë pjesë gjithësej dyqind e tetë përdorues.


Pasqyra e të dhënave

Përdoruesve ju kam ofruar tre kurse online, në tre platforma të ndryshme për planprogramin e lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, konkretisht aplikacionin e Excel-it. Në disa nga përgjigjet e dhëna në hulumtim, përdoruesit kanë arritur progres të vazhdueshëm në përmirësimin e rezultateve të lëndës, të parapara në planprogramin shkollor. Shfrytëzuesit e kursit online janë kryesisht të moshës 15, 16, 17, dhe 18 vjeç, dhe analiza rezultativisht tregon se nxënësit të cilët kanë përdorur kursin online janë më të avansuar në rezultatet e lëndës, për dallim nga ata të cilët nuk e kanë përdorur për shkak se fokusi i tyre kryesor, si material mësimor ka qenë libri, ndërsa nxënësit që e kanë përdor kursin kanë pasur edhe mundësinë e shfrytëzimit të burimeve dhe materialeve shtesë nga interneti.


Rezultatet e pyetësorit

Në pyetësor janë përgjigjur gjithësej 210 përdorues, kryesisht nxënës të shkollës së mesme të lartë, dhe rezultatet e pyetësorit janë nxjerrë nga tri platforma të ndryshme, ku nga numri i të anketuarve në platformen eduongo, dalin të jenë 52.9% femra dhe 47.1%, meshkuj; në platformën e-edukimi dalin të jenë 51.9% femra 48.1% meshkuj, ndërsa në platformën canvas janë 42.9% femra 57.1% meshkuj, të moshave të ndryshme.


1.Njohuritë e komunikuara ishin interesante dhe të dobishme? (101 responses)




(52 responses)



(46 responses)




2.Njohuritë e fituara në kurs mund të aplikohen në praktikë? (102 responses)




Eduongo

(51 responses)




e-edukimi

(49 responses)




Canvas

3.Përmbajtja e kursit ofron një qasje të re dhe kreative? (101 responses)




Eduongo

(53 responses)



e-edukimi


(47 responses)




canvas

4.Instruktori ka përvojë dhe njohuri të thella lidhur me temat në kurs?


(101 responses)



(54 responses)




(49 responses)




5.Instruktori ka shpjeguar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme temat në kurs?


(100 responses)




(54 responses)



(49 responses)




6.Dizajni dhe struktura e kursit ishte e qartë? (101 responses)




eduongo

(54 responses)



e-edukimi


(49 responses)



canvas


7. Metodat e kursit ishin praktike dhe të përshtatshme për qëllimet e kursit?

(101 responses)




eduongo

(54 responses)



e-edukimi


(49 responses)




canvas

8.Unë do ta vlerësoj prezantimin e materialeve mesimore (tekst, foto, video, shembujt, etj) ?


(101 responses)




(53 responses)



(49 responses)




9.Sa jeni të kënaqur me kursin në përgjithësi? (101 responses)




eduongo

(54 responses)




e-edukimi

(49 responses)




canvas

10.A do ta rekomandoni kursin për përdoruesit e tjerë? (100 responses)




eduongo

(52 responses)




e-edukimi

(48 responses)



canvas


11.Cila pjesë e kursit ishte më e vlefshme për ju? (99 responses)



Eduongo

- Teksti
- Fotografit
- Videot
- Kuizie
- Other


(50 responses)



e-edukimi

- Teksti
- Fotografit
- Videot
- Kuizie
- Other


(49 responses)



Canvas


- Teksti
- Fotografit
- Videot
- Kuizie
- Other

12.Çfar nuk ju ka pëlqyer ne këtë kurs? (81 responses)




Eduongo

(42 responses)




e-edukimi

(41 responses)




Canvas


13.Nga përvoja juaj:



Eduongo




e-edukimi




Canvas

14. A është e nevojshëm të përmirësojmë modulet e kursit në të ardhmen?
(100 responses)




Eduongo

(52 responses)



e-edukimi


(49 responses)



Canvas


15.A mendoni se materialet mësimore të ofruara janë adekuate për të mësuar modulin?

(100 responses)




Eduongo

(51 responses)




e-edukimi

(47 responses)




Canvas


16. A jane interesante materialet e kursit? (97 responses)



Eduongo



e-edukimi



Canvas

Komentimi i pyetjeve

Bazuar në rezultatet e pyetësorit, përdoruesit e tri platformave kanë dhënë mendimin e tyre. Në pyetjen e parë rreth njohurive të komunikuar, pra se a ishin interesante dhe të dobishme, ata u përgjigjën, në përgjithësi, në nivelin e lartë se njohuritë e komunikuar në kurs ishin të dobishme.

Në pyetjen e dytë, se njohuritë e fituara në kurs mund të aplikohen në praktikë, diku mbi 90% e përdoruesve u përgjigjën se njohuritë e fituara mund t'i aplikojnë në praktikë, gjë të cilën e kam identifikuar edhe gjatë procesit mësimor. Nxënësit të cilët kanë ndjekur kursin online Excel 2013 kanë qenë më fleksibil në arritjen e rezultateve të të nxënës.

Kur përdoruesit u pyetën nëse përmbajtja e kursit ofron një qasje të re dhe kreative, shumica e tyre u përgjigjën me vlerësimin shumë mirë dhe shkëlqyeshëm.

Në pyetjen e 4-të dhe të 5-të rreth përvojës dhe mënyrës së shpjegimit nga ana e instruktorit, përdoruesit u shprehën të kënaqur me atë se çfarë kan përfituar në kurs nga ana e instruktorit dhe propozuan që të vazhdohet me programe të tjera lëndore.

Në pyetjen e 6-të dhe të 7-të mbi atë se dizajni dhe metodat e kursit nëse ishin të përshtatshme ata u shprehën se dizajni ishte mesatarisht i mirë, ndërsa sa i përket metodave të kursit dhe praktikimit të tyre ata bënë dallimin në platforma, duke e favorizuar platformën eduongo.

Krahasimi i platformave			
Vlerësimi në kërkesa	e- edukimi	eduongo	canvas
	shkëlqyeshëm		
Dizajnimi dhe struktura e kursit ishte e qartë	22	53	20
Metodat e kursit ishin praktike dhe të përshtatshme për qëllimet e kursit	20	50	19
	Shumë mirë		
Dizajnimi dhe struktura e kursit ishte e qartë	18	36	20
Metodat e kursit ishin praktike dhe të përshtatshme për qëllimet e kursit	13	38	15
	Mirë		
Dizajnimi dhe struktura e kursit ishte e qartë	9	9	4
Metodat e kursit ishin praktike dhe të përshtatshme për qëllimet e kursit	16	8	15
	Mjaftueshëm		
Dizajnimi dhe struktura e kursit ishte e qartë	4	3	5
Metodat e kursit ishin praktike dhe të përshtatshme për qëllimet e kursit	2	5	0

Tabela 23 - Përshtatshmëria e platformave

ndërsa për dy platformat e tjera, e-edukimi dhe canvas, e vlerësuan mesatarisht mirë. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat.

Nga tabela 23; në pyetjen e 6-të dhe të 7-të janë nxjerrë përgjigjet e përdoruesve të kursit Excel 2013, ku 22 përdorues kanë përkrahur platformën e-edukimi, 53 përdorues përkrahën platformën eduongo dhe 20 përdorues platformën canvas. Sa i përket dizajnit, platforma eduongo është vlerësuar të jetë më e përshtatshme për përdoruesit, të ciltë kanë bërë vlerësimin nga një deri në pesë, ku niveli pesë konsiderohet si vlerësimi më i lartë.

Në pyetjen e radhës, rreth metodave të kursit, përdoruesit u përgjigjen në këtë mënyrë: 20 përdorues zgjedhën e-edukimi, 50 eduongon, 19 canvas-in. Konsideroj se platforma eduongo është më e përshtatshme sesa platforma e-edukimi dhe canvas për Excel 2013 sa i përket këtyre dy pyetjeve. Rezultatet e tabelës 23 janë paraqitur edhe përmes një grafiku.




Figura 31 - Përshtatshmëria e platformave përmes grafikut

Në pyetjen e 8-të dhe të 9-të rreth materialeve mësimore dhe kursit në përgjithësi, respondentët u shprehën se kombinimi i materialit me tekst, foto dhe video, ishte shumë i mirë dhe i vlefshëm për të marrë informacione. Vlerësimi i kursit, në përgjithësi, ishte shumë i mirë.

Nr.8	EG	E- edukimi	Canvas	EG	E- edukimi	Canvas	EG	E- edukimi	Canvas
Pyetja	Shkëlqyeshëm			Sh.Mirë			Mirë		
Prezanti mi; materia lit mësimore tekst, video, foto etj.	56	29	17	32	14	19	10	8	12
Sa jeni te kenaqur në përgjithësi?	57	25	20	33	21	19	9	5	9

Tabela 24 - përgjigjet për materialin mësimor

Materiali mësimor është sistemuar në tri platformat, mirëpo përdoruesit për shkak të qasjes dhe navigimit në kursin Excel 2013 kanë zgjedhur platformën eduongo si platformë më e mirë në raport me e-edukimin dhe canvas. Poashtu në pyetjen e 9-të, se sa jeni të kënaqur me kursin në përgjithësi; 57 kanë zgjedhur eduongo, 25 e-edukimi, 20 canvas. Përzgjedhja e eduongo nga ana e përdoruesve si më e mira, në përgjithësi ndodh për shkak të navigimit më të lehtë në kurs, ndërsa sa i përket organizimit të kursit, krijimit dhe menagjimit nga ana e mësimeve, atëherë si platformë më e mirë është Canvas, në raport me eduongo dhe e-edukimin.

Në pyetjen e 10-te se a do të rekomandoni kursin për përdoruesit e tjerë, të gjithë u shprehën se do të rekomandonin edhe për përdoruesit e tjerë.

Kur përdoruesit u pyetën; në pyetjen e 11-të dhe të 12-të; se cila pjesë e kursit ishte më e vlefshme për ta dhe çfarë nuk ju ka pëlqyer, ata dhanë përgjigje të ndryshme, duke përfshirë, pothuajse të gjitha pjesët e kursit, mirëpo si më e favorizuar doli të jetë video, për shkak se shumica e përdoruesve më shumë përfitojnë nga demonstrimi. Ndërsa në atë se çfarë nuk ju ka pëlqyer, pothuaj se të gjithë përdoruesit kishin ndarë mendime të ndryshme; disa nga ta nuk i kishin pëlqyer kuizet, disa të tjerë tekstin, fotografitë apo videot, e disa të tjerë ishin shprehur se nuk u ka pëlqyer navigimi e dizajni.

Çfarë nuk ju ka pëlqyer në kurs			
Vlerësimi në kërkesa	e-edukimi	eduongo	Canvas
Kuizet	31%	18.50%	24.40%

Tabela 25 - Çfarë nuk ju ka pëlqyer në kurs

Me përqindjen më të lartë të papajtueshmërisë në këtë pyetje, është dhënë përgjigja për kuizet, ku 31% e përdoruesve janë përgjigjur se kuizet e kursit Excel 2013 në platformën e-edukimi nuk i

plotësojnë kërkesat e tyre, për shkak se mbi përgjigjet që i kanë dhënë në kuiz nuk i marri rezultatet në mënyrë automatike në userin e tyre, pasi që mësimdhënësi i kursit duhet që tua dërgojë më pas përgjigjet e kuizit; 24% janë përgjigjur për platformën canvas, sepse organizimi i kuizeve ka shumë kritere dhe pragun e kalueshmërisë, gjë e cila për mësimdhënësit e platformës është e pëlqyeshme; 18.50% të përdoruesve nuk ju kanë pëlqyer kuizet në platformën eduongo. Pra, në bazë të rezultateve të paraqitura në tabelën e mësipërme, prapëprapë platforma eduongo, në krahasim me dy platformat e tjera, është më e përshtatëshme.

Në pyetjen e 13-të se a është e vështirë qasja në kurs, pastaj se sa është efektiv për t'i arritur qëllimet apo sa është i lehtë për përdorim e komunikimi me instruktorin si dhe organizimi i kuizeve, përdoruesit u përgjigjen mesatarisht mirë; në pikën e tretë, se sa është i lehtë kursi për përdorim, ata kishin favorizuar platformën eduongo në krahasim me dy të tjerat.

Nga përvoja juaj:	e-edukimi	eduongo	canvas
A është e vështirë qasja në kurs	Mirë	Mjaftueshëm	Mirë
Sa është efektiv për t'i arritur qëllimet, objektivat e të nxënësve	Mjaftueshëm	Sh.Mirë	Mjaftueshëm
Sa është i lehtë kursi për ta përdorur	Mirë	Shkëlqyeshëm	Mirë
Komunikimi me instruktorin ishte shumë i lehtë	Shkëlqyeshëm	Shkëlqyeshëm	Shkëlqyeshëm

Tabela 26 - Vështirësitë e përdorimit të kursit.

Përdoruesit në pyetjen e parë kanë dhënë përgjigje, pothuajse të njejtë rreth qasjes në kurs; në pyetje e dytë, afërsisht, përgjigja është mesatare, ndërsa në pyetjen e tretë është bërë dallimi mes platformave, ku e-edukimi është përzgjedhur si platformë e mirë, eduongo si platformë e shkëlqyeshme dhe canvas si platformë e mirë për kursin Excel 2013.

Në pyetjen e 14-të dhe 15-të, se a është e nevojshme të përmirësohen modulet e kursit në të ardhmen dhe sa janë adekuate materialet mësimore për kursin, ata u shprehën, diku mbi 80% se me ndryshimin e planprogrameve, ndryshimi i versioneve është i nevojshëm ashtu si edhe që të përmirësohen modulet, si dhe materialet mësimore në këtë fazë janë të nevojshme për t'i shfrytëzuar.

Në pyetjen e 16-të a janë interesante materiat e kursit, shumica e tyre u përgjigjën me shpeshherë - herë pas here.

Marrë parasysh të gjitha këto përgjigje të nxënësve, ftojmë të gjitha institucionet relevante dhe kompetente që të investojnë në infrastrukturën shkollore dhe të orfojnë kushte për zhvillimin e mësimi online, duke marrë parasysh rezultatet e të nxënësve dhe sukseset e nxënësve në përgjithësi.

Bazuar në hulumtim dhe praktikat profesionale, rezultatet e hulumtimit tregojnë përparësitë që ka mësimi në distancë dhe përveç mbështetjes së mësimi në klasë, një gjë e tillë u ofrohet edhe përdoruesve të tjerë, pa dalluar klasën apo moshën e tyre. Gjithashtu, përdorimi i mësimi në distancë, ngre cilësinë dhe ofron rezultatet e të nxëniti në formë shumë më të shpejtë për të gjithë përdoruesit e kursit; ta zëmë, metodologjia e vlerësimit, ku si instrument të vlerësimit marrim testin , me ç'rast komunikimi me të tjerët është jashtëzakonisht më shpejtë, në kuptim të qasjes në informata e poashtu edhe në organizimin e materialit mësimor, dhe përfundimisht përparsi e veçantë në shfrytëzimin e materialit mësimor. Përdorimi i teknologjisë informative dhe komunikimit është i nevojshëm dhe madje i domosdoshëm për mësimin në distancë, pasi mësimdhënësve u mundëson menagjim më të mirë në arritjen e qëllimeve, parimeve dhe rezultateve të të nxëniti. Në bazë të analizave të hulumtimit, kursi për mësim në distancë, është i thjeshtë për t'u përdorur, pasi që për disa shfrytëzues mund të përdoret pas një trainimi të shkurtër, si edhe për faktin se kursi mund të përdoret për çdo fushë apo lëndë mësimore.

Metodologjia e nxënjes përmes mësimi në distancë ndryshon rolin dhe qasjen e mësimdhënies tradicionale në shkolla (klasë), ndaj për t'u aplikuar mësimi në distancë në shkollat tona, nevojitet që çdo klasë të paiset me teknologji e mjete informacioni e komunikimi. Shkolla duhet të ketë qasje në internet nga të gjithë përdoruesit dhe për secilë klasë duhet të ketë një lloptop ose kompjuter personal, të ketë projektor si dhe drejtimet apo lëndët e TIK-ut të jenë të paisura me kabinete të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Mësimdhënësit, të cilë kanë nevojë të ndërrojnë klasën, përbrenda objektit shkollor, mund të llogohen në secilën klasë që shkojnë, pa pasur nevojë të bartin me vete paisje të TIK-ut. Mësimdhënësi bënë prezantimin e temës mësimore në bazë të planifikimit të asaj orë, më pas angazhon nxënësit për t'i nxjerrur rezultatet e panifikuar nga vetë mësimdhënësi, me ç'rast realizohet mësim i kombinuar në shkollë. Përgjatë 24 orëve, nxënësit do të qasen në klasën virtuar dhe do të kenë mundësinë të trajtojnë temat mësimore, që kanë shtjelluar në shkollë.

Kështu përforcohet bindja se mësimi në distancë ka shumë përparësi për përdoruesit e mësimdhënësit, pasi që ata mund të gjejnë bashkëpunim të ngushtë mes tyre. Secili mësimdhënësi mund të ketë qasje në klasën tjetër në rolin e mësimdhënësit dhe kjo mundë të realizohet tek aktivet profesionale p.sh. tre mësimdhënësi të TIK-ut mund të korrespondojnë me njëri-tjetrin në lëndën e tyre.

Gjatë hulumtimit, sfidë kryesore ka qenë implementimi i mësimi në distancë në shkolla, për shkak të infrastrukturës shkollore që duhet të jetë fokusi kryesor i organeve kompetete me qëllim investimi në teknologjinë informative dhe të komunikimit.

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit, tani në botën modern, është bërë pjesë e pandashme e të gjitha fushave, sidomos në mësimnxënie, ndaj përdorimi i kurseve për mësim në distancë arrinë rezultatet e kompetencave të parapara në kurrikulat e reja në vendin tonë dhe rajon, duke pasur parasysh qasjen praktike dhe të drejtpërdrejtë nga nxënësit dhe mësimdhënësit. Mësimi në distancë mundëson të shprehurit nëpërmjet njohurive faktike dhe procedurale, nëpërmjet shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave që duhet të zhvillohen te nxënësit gjatë periudhave të caktuara kohore si dhe qasjet, metodologjitë e zbatueshmërisë, monitorimin dhe vlerësimin.

Organet kompetente dhe udhëheqëse në Kosovë duhet të ofrojnë platforma elektronike për menaxhimin e mësimi online, ku disa nga platformat integrohen pa vështirësi, ndërsa dihet se ato nuk kanë nevojë për një softëer, i cili do të kishte ngarkuar kompjuterin, pra mund t'i shfrytëzojmë plotësisht të dhënat dhe burimet. Tanimë mësimi elektronik duhet të përkrahet patjetër, sepse na mundëson të ecim në hap me kohën, duke i përcjellur ndryshimet dhe trendet bashkëkohore në arsimin e përgjithshëm.

Fillimisht duhet që të investohet në infrastrukturën shkollore me paisje teknologjike, të cilat përkrahin mesimin online. Ky investim mund të bëhet nga Drejtoritë Komunale të Arsimit ose edhe nga vetë shkolla me buxhetin që i përcakton Ministria e Arsimit. Duhet të investohet në rrjetëzimin e shkollave për qa, në LAN ose Ëirles; në çdo klasë të ketë një kompjuter, pastaj projektor, i cili mundëson qasjen e mësimdhënësit në platformë. Tek pastaj, në fazat tjera duhet të investohet në formimin e laboratoreve e kabineteve të TIK-ut, ku mund të kenë qasje edhe nxënësit. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë mund të përzgjedhë njëren nga platformat e mësimi online dhe ta aplikojë në gjithë sistemin arsimor në Kosovë si dhe të ofrojë trajnime për mësimdhënësit, të cilët kanë vështirësi në përdorimin e platformave online.

Përfundimisht, përdorimi i mësimi në distancë mundëson komunikim më të shpejtë, dhe rezultativisht përpunim të informacioneve në platformën online, e përmes kësaj trajtimi gjithpërfshirës, dominim të pozitës aktive të nxënësve dhe rol drejtues të organizuesit - mësimdhënësit dhe shfrytëzim racional e cilësor të materialit multimedial: tekstit, figurës, zërit e videos, që jo vetëm tërheqin vëmendjen e nxënësve, por edhe i rrisin ata cilësisht në mësimnxënie.

Biblografia

- 1) Epignosis LLC 315 Montgomery Street, 8th and 9th Floors, San Francisco, California, CA 94104
- 2) United States of America E-LEARNING CONCEPTS, TRENDS, APPLICATIONS
- 3) Strategjia Nacionale për Zhvillimin e Shoqërisë Informatike 2005-2015
- 4) Insitituti i Zhvillimit të Arsimit ,Ministria e Arsimit dhe Shkencws
- 5) Joy Egbert and Elizabeth Hanson-Smith., CALL Environments: Research, Practice, and Critical Issues
- 6) Learning objectives can also include performance conditions (i.e. the context in which the behaviour will be performed, such as “orally”); and performance criteria
- 7) A learning object is the smallest reusable collection of content supporting a specific learning concept or objective.
- 8) A modular curriculum is made up of standardized units that can be separated from each other and rearranged or reused.
- 9) E-learning methodologies A guide for designing and developing e-learning courses, This guide was prepared in the context of the FAO Trust Fund Project GCP/GLO/279/GER entitled: “Improving the abilities of Regional Organizations to develop, implement and monitor food security training programmes”. The project is funded by the Government of Germany and implemented by FAO.Rome, 2011.
- 10) The standard structure of an e-learning lesson reflects Gagné’s nine events of instruction: 1) Gain attention; 2) Inform learner of objective; 3) Stimulate recall of prior knowledge; 4) Present the material; 5) Provide guidance for learning; 6) Elicit performance; 7) Provide feedback; 8) Assess performance; and 9) Enhance retention and transfer (See Gagné 1985)
- 11) www.eduongo.com
- 12) De Rosa C., FAO’s Reference Manual on ‘Good learning practices for effective capacity development’. Learning Module 3 of the Capacity Development Learning Programme series, Office of Knowledge and Capacity for Development (OEKC), FAO 2011.
- 13) Clark R.C., Mayer R.E., e-Learning and the Science of Instruction - Proven Guidelines for Consumers and Designers of Multimedia Learning, Second Edition, Pfeiffer 2005
- 14) http://tik-10.eduongo.com/v2/desktop/app/settings/list_view
- 15) Kirkpatrick D.L. and Kirkpatrick J.D. (2006). Evaluating Training Programs. The Four Levels. San Francisco: Berrett-Koehler Publishers.
- 16) A fifth level of Kirkpatrick’s evaluation model, the Return on Investment (ROI), has been introduced by Jack J. Phillips. According to Phillips, the ROI is a comparison between benefits and costs: $ROI = \text{Net Programme Benefits} / \text{Programme Costs}$. See J.J. Philips (1997). Return on Investment in Training and Performance Improvement Programs, Gulf Pub Co.
- 17) Teknologjia Informatike Komunikuese në Arsim - skriptë interne M-r. Fisnik Dalipi UNIVERSITETI” Sh. Kirili dhe Metodi” Fakulteti Pedagogjik, Shkup.

- 18) INTEGRIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË EDUKIM NË SHQIPËRI
- 19) <http://eduongo.com/academy>
- 20) <https://tik-10.eduongo.com/v2/desktop/desktop/login/>
- 21) TEKNIKAT E MËSIMIT INTERAKTIV, DORACAK PËR PROFESORËT E FAKULTETIT JURIDIK TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS. Specialistja e mësimi ligjor, ABA/RULE OF LAW INITIATIVE Profesoresha Mary Pat Treuthart Universiteti Gonzaga, Fakulteti Juridik Spokane, Washington SHBA & Instituti për Ligjërime në Fakultetet e Drejtësisë
- 22) <http://tik-10.eduongo.com/v2/desktop/desktop/home/>
- 23) E-edukimi.rks-gov.net
- 24) canvas.instructure.com/login/canvas
- 25) E-course development and teaching with Moodle 1.9
- 26) Smart Remote Classroom: Creating a Revolutionary Real-Time Interactive Distance Learning System* Yuanchun Shi, Weikai Xie, and Guangyou Xu Dept. of CS, Tsinghua University, Beijing 100084, China
- 27) Development of an Interactive Learning Management System for Malaysian Distance Learning Institutions. Ibrahim Almarashdeh, Nur Fazidah Elias, Noraidah Sahari and Nor Azan Mat Zain
- 28) Kriteret për Akreditimin e Aktiviteteve të të Mësuarit në Distançë. Qendra Kombëtare e edukimit në vazhdim.
- 29) Lori Caudle, "Designing an Interactive Online Seminar Course for Distance Learning Interns: Combining Technology Tools and Facilitating Meaningful Discourse" (March 7, 2012). SoTL Commons Conference. Paper 4.
- 30) Application of interactive course management system in distance learning of material science. L.A. Dobrzański*, R. Honysz, Z. Bryta.
- 31) Analysis of quality-of-service in a wide-area interactive distance learning system. Thomas Plagemann and Vera Goebel. UniK – Center for Technology at Kjeller, University of Oslo, Granaveien 33, P.O. Box 70, N-2007 Kjeller, Norway.
- 32) Metodologjitë e mësimi elektronik. Nebi Caka
- 33) E-Learning Success in Action! From Case Study Research to the creation of the Cybernetic e-Learning Management Model Bernd Hilgarth. 1 Department of Computer Science and Information Systems, University of Jyväskylä, Agora, 40014 University of Jyväskylä, Finland.
- 34) Arbnesha Mexhuani INTEGRIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE TË KOMUNIKIMIT NË MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE
- 35) Bashkim Azemi & Bekim Morina, Aparatura didaktike në tekstet shkollore, Prishtinë, 2013, Instituti Pedagogjik i Kosovës.